



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Marketingu Digjital”

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Prof. Asoc. Dr. Edmond Kadiu

Shtator / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË “MARKETINGU DIGJITAL”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Marketing – Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Marketingu Digjital”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 338, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 63, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik (2 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 12 PAE / 0 PAK 2023-2024: 10 PAE / 0 PAK 2024-2025: 10 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023: 15 studentë 2023-2024: 10 studentë 2024-2025: 15 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital” ofrohet nga Departamenti Marketing - Turizmit, i Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin Fan S. Noli, Korçë (UNIKO). Ky program realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik, 2 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë në “Master Profesional në Marketingu Digjital”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Hapja e programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 338, datë 17.09.2021. Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut për specialistë në fushën e Marketingut Digjital.

Qëllimi i programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” është të zhvillojë njohuri të avancuara dhe kompetenca në fushën e marketingut, duke u përqëndruar në menaxhimin e marketingut online, analizën e të dhënave digjitale, strategjitë e reklamimit online dhe përdorimin e platformave të reja teknologjike. Gjithashtu synimi është thellimi i njohurive teorike të fituara në ciklin e parë të studimeve, zhvillimi i të menduarit kritik dhe aftësive analitike për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve marketing. Programi refleton një strukturë mësimore të solide, mbështetur në eksperiencën e gjatë akademike dhe profesionale të UNIKO. Programi është i strukturuar në përputhje me standardet kombëtare të arsimit të lartë dhe ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushën e Marketingut Digjital. Programi i studimit u jep mundësi të shumta punësimi studentëve si menaxher i marketingut digjital, specialist i SEO, menaxher i mediave sociale, menaxher i përmbajtjes digjitale, analist i të dhënave marketing, menaxher i reklamave në Google/Facebook, ekspert i marketingut të automatizuar, konsulent i marketingut digjital, menaxher i markës, etj.

Ky raport i përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm ka për qëllim vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital” që ofrohet nga Departamenti Marketing - Turizëm, i Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin Fan S. Noli, Korçë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital”, nëpërmjet shërbimit në AMS.

Gjatë procesit të vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli dhe Prof. Asoc. Dr. Edmond Kadiu është mbështetur nga Z. Muhamed Prezja, koordinator teknik i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), GVJ ka analizuar gjetjet e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) bashkë me anekset si dokumentacion mbështetës dhe evidencat e përgatitura nga strukturat përkatëse. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që japin mësim, sigurimit të cilësisë, etj. Gjatë analizës së RVB, janë evidentuar disa pyetje e komente të cilat përbënë bazën e diskutimeve në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion. Vizita në institucion u zhvillua në datat 5 dhe 6 Mars 2025, mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë ku u realizuan një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanen e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit Marketing – Turizëm, si departamenti përgjegjës për këtë program studimi. Gjithashtu GVJ zhvilloi takime dhe diskutime me GVB, stafin akademik dhe studentët e këtij programi, përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, etj. Gjatë diskutimit me të gjithë pjesmarrësit në takime u sqaruan çështjet sipas pyetjeve të përgatitura më parë nga GVJ. Gjithashtu, përmes vizitës në institucion, GVJ është njohur më nga afër me infrastrukturën fizike dhe mësimore, vizitoi auditorët, bibliotekën, etj, për të parë nga afër përputhshmërinë e tyre me standardet cilësore të mësimdhënies. GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për organizimin e takimeve, dhe vënien në dispozicion të çdo dokumenti apo informacioni të kërkuar për këtë proces.

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/97 Prot, datë 29.07.2025. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, njofton nëpërmjet sistemit në datë 01.09.2025, nëpërmjet shkresës me Nr. 1512/1, Prot, datë 01.09.2025, “Dërgohen komentet për draft raportin e vlerësimit të jashtëm Master Profesional në Marketingu Digjital”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë (UNIKO) është një universitet publik me një përvojë mbi 30 vjeçare në arsimin e lartë, që ofron një spektër të gjerë të programeve në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, shkencave humane dhe natyrore. Misioni i UNIKO është “<i>të kontribuojë në zhvillimin rajonal e më gjërë, nëpërmjet përgatitjes së specialistëve në këto fusha duke integruar kërkimin shkencor, edukimin dhe shërbimin ndaj publikut. Universiteti ofron edukim cilësor dhe nxit përgatitjen profesionale dhe personale për çdo student që kërkon të ndërtojë një karrierë produktive dhe të ketë përgjegjësi sociale</i>”. Në Planin Strategjik 2022-2027, UNIKO shprehet se vizioni i tij është “<i>të jetë qendra më e rëndësishme e jetës akademike dhe shkencore në rajonin e Korçës, duke kontribuar në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve lokale, rajonale dhe më gjerë, nëpërmjet programeve të studimit që ofron në fushat e ekonomisë, bujqësisë, shkencave humane dhe sociale, shkencave natyrore dhe shkencave të edukimit</i>”. Mbështetur tek Statuti dhe Plani Strategjik i Zhvillimit të institucionit, GVJ konstaton se UNIKO në mbështetje të misionit dhe vizionit të vet, kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare nëpërmjet programeve të studimit që ofron. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”.pdf - Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.pdf

Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Marketingu Digjital” përcakton qartë qëllimin dhe objektivat formuese të programit. Programi synon përgatitjen e studentëve në fushën e marketingut me njohuri dhe aftësi të avancuara për analizimin e të dhënave, menaxhimin e fushatave digjitale dhe përdorimin e mjeteve teknologjike, duke ju mundësuar atyre përshtatjen me nevojat e tregut modern digjital dhe transformimin digjital të organizatave. Programi i ofron studentëve mundësi të gjera punësimi në industrinë e marketingut por edhe në drejtime të tjera të fushës së ekonomisë. GVJ konstaton se këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit si dhe janë brenda fushës së veprimtarisë së tij. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”.pdf - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Programi i studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti Marketing – Turizëm i Fakultetit të Ekonomisë në UNIKO. Sipas Rregullores së programit, ai ka si objektiv formimin e profesionistëve marketerë digjitalë në përputhje me kushtet e reja ekonomiko-shoqërore në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Në këtë kuadër ky program vjen si një pjesë organike e Fakultetit të Ekonomisë, në përputhje me drejtimin akademik të tij dhe të vetë institucionit. GVJ gjithashtu konstaton se programi ecën në të njëjtën linjë me Planin Strategjik 2022-2027 të UNIKO, ku theksohet se institucioni po fokusohet tek hapja e programeve të reja me natyrë ndërdisiplinare sipas nevojave të tregut të punës, një nga të cilët është edhe “Marketingu Digjital”, ku ndërthuren teknologjia me fushën ekonomike. GVJ konstaton gjithashtu se programi i studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” ofrohet në përputhje me Rregulloren e tij e cila mbështetet tek Rregullorja e UNIKO, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e brendëshme e Departamentit “Marketing – Turizëm”. <u>Referenca:</u>


	- Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO - Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.pdf - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.34 Rregullore e Brendshme e FE.pdf - Shtojca 1.46 Rregullore e DMT
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ konstaton se programi është ndërtuar në përputhje me strategjitë kombëtare për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe arsimimit të lartë, me “Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030”, si dhe me “Strategjinë e Specializimit Inteligent (S3)”, duke pasur në fokus rritjen e aftësive digjitale të studentëve. Programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” synon përgatitjen e specialistëve për përdorimin e teknologjisë digjitale për të rritur kapacitetet e marketingut të bizneseve shqiptare dhe për të ndihmuar në transformimin e tyre digjital. Programi gjithashtu vjen në një linjë me prirjet globale të zhvillimit në fushën e marketingut mbështetur tek mundësitë që ofron teknologjia. Ai përfshin module që trajtojnë teknikat e fundit të marketingut digjital, analitikës së të dhënave, menaxhimit të platformave sociale dhe optimizimit të motorëve të kërkimit, duke përgatitur studentët që ti përshtaten nevojave të tregut të punës vendas dhe të huaj. <u>Referenca:</u> - Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 20.9.2023 - Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) Informacion & Metodologjia S3 Albania
Konkluzione	Misioni i UNIKO është të kontribuojë në zhvillimin rajonal e më gjërë, nëpërmjet përgatitjes së specialistëve në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, shkencave humane dhe natyrore, duke integruar kërkimin shkencor, edukimin dhe shërbimin ndaj publikut. Universiteti ofron edukim cilësor dhe nxit përgatitjen profesionale dhe personale për çdo student që kërkon të ndërtojë një karrierë produktive dhe të ketë përgjegjësi sociale. GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të misionit dhe vizionit të vet, nëpërmjet programeve të studimit që ofron kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore

	kombëtare. Objektivat e programit janë në përputhje me misionin dhe qëllimet e insitucionit si dhe janë brenda fushës së veprimtarisë së tij. GVJ gjithashtu konstaton se programi ecën në të njëjtën linjë me Planin Strategjik 2022-2027 të UNIKO, ku theksohet se institucioni po fokusohet tek hapja e programeve të reja me natyrë ndërdisiplinare sipas nevojave të tregut të punës, një nga të cilët është edhe "Marketingu Digjital", ku ndërthuren teknologjia me fushën ekonomike. Programi është ndërtuar në përputhje me strategjitë kombëtare për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe arsimit të lartë, gjithashtu vjen në një linjë me prirjet globale të zhvillimit në fushën e marketingut mbështetur tek mundësitë që ofron teknologjia.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Mbështetur tek dokumentat e shqyrtuara si dhe takimi me stafin akademik në institucion, GVJ konstaton se UNIKO ka një përvojë të gjatë në fushën e arsimit universitar të cilën e mbështet në një staf të kualifikuar dhe me përvojë akademike. GVJ konstaton se i gjithë stafi akademik që mbulon programin e studimit "Marketingu Digjital" mban gradën shkencore Doktor ose titullin akademik Profesor i Asociuar. Kualifikimi i stafit është në përputhje me fushën akademike specifike të këtij programi studimi. Ngarkesa mësimore e këtij programi studimi mbulohet e gjitha nga staf akademik efektiv. <u>Referenca:</u> - https://unkorce.edu.al/historiku/ - Tabela Perfundimtare MD.pdf
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit	Departamenti Marketing – Turizëm përgjigjës për këtë program studimi është njësi mësimore-kërkimore në Fakultetin e Ekonomisë në UNIKO. Ai përfshin fusha kërkimi të përafërta

duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	dhe në përputhje me ato të njësish kryesore (Rregullore e FE Neni 6, Rregullore e DMT Neni 5). Programi “Marketingu Digjital” i përket fushës së marketingut dhe fokusohet në aspektet moderne të tij, si marketingu në rrjetet sociale, analizat e të dhënave dhe strategjitë e komunikimit digjital, etj. Marketingu është një fushë e rëndësishme e kërkimit shkencor në Fakultetin e Ekonomisë të UNIKO, gjë që reflektohet në ofrimin e disa programeve të studimit në këtë fushë si në nivelin bachelor edhe atë master. Në lidhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programit, GVJ konstaton se kodifikimi i këtij programi studimi është kryer në përputhje me VKM nr. 310, datë 11.5.2022, Udhëzimin e MAS nr. 31, date 15.11.2022 dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Përkatësisht kodi i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Marketingu Digjital” është 71MP0414S. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit te Studimit MD.pdf - Shtojca 1.46 Rregullore e DMT - Shtojca 1.34 Rregullore e Brendshme e FE.pdf - Shtojca 2.15 Kodifikimi i programit te studimit.pdf
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Bazuar tek Rregullorja e programit, GVJ konstaton se ky program sykon ofrimin e njohurive të avancuara mbi konceptet, teoritë dhe praktikat kryesore të marketingut digjital, si dhe thellimin e njohurive teorike të marketingut, veçanërisht ato të fituara në ciklin e parë të studimeve në programet që ofrohen nga Departamenti i Marketing -Turizëm në Fakultetin e Ekonomisë në UNIKO. Në këtë kontekst programi është në përputhje të plotë me fushën e përgjithshme të njësish bazë, duke ju dhënë mundësi studentëve të vazhdojnë studimet brenda fushës së tyre nga niveli bachelor në master. Gjithashtu GVJ konstaton se departamenti ka një staf të kualifikuar (CV e stafit, Aktiviteti Shkencor i DMT) dhe me ekspertizë në fushën e marketingu, me kontribut si në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor në këtë fushë. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit te Studimit MD.pdf




	- <i>Shtojca 1.46 Rregullore e DMT</i> - <i>Shtojca 2.14 Cv e stafit ndihmes-akademik.pdf</i> - <i>Shtojca 4.7 Aktiviteti kerkimor-shkencor i dmt.pdf</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i studimit Master Profesional “Marketingu Digjital”, nuk ofrohet në partneritet me ndonjë institucion tjetër.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që ofrojnë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar, në bashkëpunim me punëdhënësit dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Qendra e Karrierës dhe Alumni synon të ndihmojë studentët dhe të diplomuarit në planifikimin e karrierës së tyre dhe në përgatitjen për tregun e punës. Ajo zhvillon trajnime për zhvillimin e aftësive profesionale, i ofron studentëve seminare informuese dhe takime me përfaqësues të biznesit dhe administratës publike. Gjithashtu Qendra për Formimin e Vazhduar ofron shkolla verore dhe trajnime të ndryshme. Specifikisht për këtë program studimi është organizuar një aktivitet nga Fakulteti i Ekonomisë në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, ku studentët e programeve të marketingut u angazhuan në një “Ditë të Hapur” me fokus në marketingun dixhital. <u>Referenca:</u> - https://unkorce.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni-3/ - https://unkorce.edu.al/qendra-per-formimin-e-vazhduar-2/
Konkluzione	GVJ konstaton se UNIKO ka një përvojë të gjatë në fushën e arsimit universitar të cilën e mbështet në një staf të kualifikuar dhe me përvojë akademike. I gjithë stafi akademik që mbulon programin e studimit “Marketingu Digjital” mban gradën shkencore Doktor ose titullin akademik Profesor i Asociuar. Programi “Marketingu Digjital” i përket fushës së marketingut dhe fokusohet në aspektet moderne të tij, si marketingu në rrjetet sociale, analizat e të dhënave dhe strategjitë e komunikimit digjital, etj, duke qenë në përputhje me fushat e kërkimit shkencor në Fakultetin e Ekonomisë të UNIKO. Gjithashtu ky program

	është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, vjen në të njëjtën fushë me programe të ciklit të parë të ofruara nga Departamenti Marketing - Turizëm. GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që ofrojnë trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar, në bashkëpunim me punëdhënësit dhe aktorë të tjerë të tregut të punës si Qendra e Karrierës dhe Alumni dhe Qendra për Formimin të Vazhduar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi i studimit "Marketingu Digjital" ka një ndërthurje të fushës së marketingut dhe asaj të teknologjisë së informacionit dhe si i tillë ka një natyrë ndërdisiplinare. Për realizimin e programit mësimor Departamenti Marketing – Turizëm përgjegjës për këtë program studimi bashkëpunon me njësi të tjera të Fakultetit të Ekonomisë, por edhe të fakulteteve të tjera në UNIKO, si Departamentin e Menaxhimit dhe Departamentin e Informatikës (Tabela 12: Tabelat Përmbledhëse) duke pasur marrëdhënie të frytshme me to. Gjithashtu institucioni ka parashikuar në Statutin (Kreu II) dhe Rregulloren (Kreu II) e tij mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërëse të tij. Çdo njësi ka detyra dhe objektiva të qarta, ku njësitë bazë organizojnë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ata përfaqësojnë. Në ndihmë të tyre vijnë edhe struktura të tjera si struktura ndihmësakademike apo administrative, të cilat merren me kurrikulat, sigurimin e brendshëm të cilësisë, burimet njerëzore, etj. Përsa i përket analizës së punës së njësive institucionale,

	institucioni ka hartuar Raportin e Analizës Vjetore të FE 2023-2024, në të cilin prezantohen analizat e detajuara në lidhje me realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies, aspekteve që lidhen me bashkëpunimet, kërkimin shkencor, infrastrukturën, sigurimin e brendshëm të cilësisë, etj. <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'.pdf - Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO - Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarise se FE.pdf
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, si dhe informacionin e marrë nga vizita në institucion, GVJ konstaton se UNIKO ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucionet private dhe publike në vend, me qëllim realizimin e praktikave të studentëve, të trajnimeve, përmirësimit të kurrikulave, angazhimit të studentëve për realizimin e temave të diplomës, me qëllim punësimin, etj. Gjithashtu vlen për tu theksuar se UNIKO ka përfituar nga marrëveshjet me universitete ndërkombëtare përmes programit Erasmus+ duke ju mundësuar mobilitetin pedagogëve dhe studentëve. Konkretisht nga këto bursa kanë përfituar 5 pedagogë dhe 2 studentë nga Departamenti Marketing – Turizëm përgjegjës për këtë program studimi. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale.pdf - Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi te FE dhe DMT.pdf - Shtojca 3.8 Mobilitette te stafit dhe studenteve.pdf - Shtojca 1.38 Te dhena per personelin akademik te DMT.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe sipas konfirmimeve të kryera pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar rreth 50 marrëveshje bashkëpunimi të posaçme me universitete në vend dhe jashtë, si edhe me institucione të tjera ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit sidomos në fushën e

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	turizmit. Një listë me universitetet dhe bizneset bashkëpunuese është dhënë në shtojcën 1.42 “Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT”. Këto marrëveshje kanë për qëllim zhvillimin e praktikave profesionale apo edhe punësimin sezonal të studentëve duke i përgatitur ata për tregun e punës. Përsa i përket mobiliteteve, sikurse u evidentuar në kriterin 2 të këtij standardi, studentët dhe pedagogët e Departamentit Marketing – Turizëm kanë përfituar bursa mobiliteti nga marrëveshjet e institucionit me universitete homologe në Francë, Bullgari dhe Serbi (Shtojca 3.8). <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT.pdf - Shtojca 3.8 Mobilitete të stafit dhe studentëve.pdf
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga takimi në institucion me drejtuesin e Departamentit të Marketing – Turizmit, GVJ u informua që departamenti harton një raport vjetor periodik (Shtojca 3.2), i cili analizon arritjet e programit, ecurinë mësimore, kërkimore dhe shkencore të departamentit, etj. GVJ, pas shqyrtimit të Raportit të Analizës Vjetore vërejtë se në këtë të fundit jepet një informacion për përfitimet nga bashkëpunimet (Tabela 1) si dhe për mobilitetet në kuadrin e programeve Erasmus + (Tabela 2). <i>Përsa i përket analizës së përfitimit nga bashkëpunimet, GVJ e shikon disi të kufizuar në këtë raport. Duke marrë shkas nga lista e pasur e aktiviteteve të Departamentit të Marketing – Turizmit (Shtojca 1.43), të cilat vijnë edhe si rezultat i këtyre bashkëpunimeve. GVJ sugjeron pasqyrimin dhe analizimin më të detajuar të tyre edhe në Raportin e Analizës Vjetore të Departamentit.</i> <u>Referenca:</u> - Shtojca 3.2 Raporte të analizës vjetore të DMT.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete të DMT.pdf
Konkluzione	<i>Institucioni ka parashikuar në Statutin dhe Rregulloren e tij mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërëse të tij, i cili është i koordinuar dhe</i>




	frytdhënës. Për realizimin e programit mësimor Departamenti Marketing – Turizëm bashkëpunon me njësi të tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe të UNIKO, si Departamentin e Menaxhimit dhe Departamentin e Informatikës duke pasur mardhënie të frytshme me to. Institucioni ka nënshkruar rreth 50 marrëveshje bashkëpunimi të posaçme me universitete në vend dhe jashtë, si edhe me institucione të tjera ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit sidomos në fushën e turizmit. Studentët dhe pedagogët e Departamentit të Marketing – Turizmit kanë përfituar bursa mobiliteti nga marrëveshjet e institucionit me universitete homologe në Francë, Bullgari dhe Serbi. Përsa i përket analizës së punës së njërive institucionale, institucioni ka hartuar Raportin e Analizës Vjetore të FE 2023-2024, në të cilin prezantohen analizat e detajuara në lidhje me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të institucionit. Gjithashtu edhe Departamenti Marketing - Turizëm harton një raport vjetor periodik i cili analizon arritjet e programit, ecurinë mësimore, kërkimore dhe shkencore të departamentit, përfitimin nga bashkëpunimet, projektet, etj. Përsa i përket analizës së përfitimit nga bashkëpunimet, GVJ e shikon disi të kufizuar në këtë raport. Duke marrë shkas nga lista e pasur e aktiviteteve të Departamentit të Marketing – Turizmit, GVJ sugjeron pasqyrimin dhe analizimin më të detajuar të tyre edhe në Raportin e Analizës Vjetore të Departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (Shtojca 2.1), GVJ konstaton se programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Marketingu Digjital” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ofrohet me kohë të plotë, me një kohëzgjatje 1 vit akademik, në përfundim të të cilit studenti fiton 60 kredite dhe pajiset me diplomë në “Master Profesional Marketingu Digjital” në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe. Elementët që përbëjnë strukturën e këtij programi janë në përputhje me aktet ligjore (VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019) përsa i përket komponentëve mësimorë si dhe përqindjes së krediteve për secilin nga komponentët, përkatësisht: - Kategoria A: Lëndët Bazë kanë 8.3% të totalit të krediteve; - Kategoria B: Lëndët Karakterizuese kanë 40% të totalit të krediteve; - Kategoria C: Lëndët Ndërdisciplinore kanë 30% të totalit të krediteve; - Kategoria D: Lëndët Plotësuese kanë 10% të totalit të krediteve; - Kategoria E: Detyrimet Përmbyllëse kanë 11.7% të totalit të krediteve; <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.36 Urdher i hapjes së programit të studimit MD.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesimore të MD.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e	Sipas Rregullores, programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” synon të zhvillojë njohuri të avancuara

shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	dhe kompetenca në fushën e marketingut, duke u përqëndruar në menaxhimin e marketingut online, analizën e të dhënave digjitale, strategjitë e reklamimit online dhe përdorimin e platformave të reja teknologjike. Gjithashtu synimi është thellimi i njohurive teorike të fituara në ciklin e parë të studimeve, zhvillimi i të menduarit kritik dhe aftësive analitike për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve marketing. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor GVJ konstaton se tërësia e lëndëve në këtë program studimi mundëson arritjen e këtyre objektivave, dhe ofron një mbulim të mjaftueshëm të njohurive që nevojiten për specialistët e marketingut që do të operojnë në tregun digjital, si specialist të SEO, menaxher i mediave sociale, menaxher i përmbajtjes digjitale, i reklamave në Google/Facebook, etj. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesimore të MD.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar tek plani mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Përkatësisht sipas Planit Mësimor Praktika ka 2 kredite (ECTS) dhe detyrimet përmbyllëse shlyhen me Tezë Diplome që ka 7 kredite (ECTS) (Shtojca 2.1). <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.1 Planet mesimore të MD.pdf
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të	N / A

studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N / A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Mbështetur tek informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Marketing – Turizmit, dokumentacioni i shqyrtuar (Plani Mësimor i detajuar), si dhe vetëdeklarimi në RVB, GVJ konkludon se ky program studimi ka ngjashmëri me programe të ngjashme që ofrohen në IAL të tjera në vend. Pavarësisht se nuk ka të njëjtën emërtesë me këto programi ka një ngjashmëri në përmbajtjen e programit në nivelin 70%.
	<u>Referenca:</u>




	- Shtojca 2.1 Planet mesimore te MD.pdf - Raporti MD.pdf - Shtojca 2.12 Programe te ngjashme MD.pdf
Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Shtojca 2.15), GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe propozuar kodifikimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital” në përputhje me VKM nr. 310, datë 11.5.2022 dhe fushën e studimit të këtij programi, si dhe ka dërguar propozimin dhe argumentimin për kodifikimin e programit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në 14.02.2023, sipas legjislacionit në fuqi. <u>Megjithatë në dosjen e vetëvlerësimit GVJ nuk gjen një dokument zyrtar të përgjigjes së MAS mbi miratimin e procesit të kodifikimit.</u> Gjithsesi, GVJ konkludon në bazë të propozimit të institucionit për kodifikimin e programeve të veta të studimit, që ky propozim është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e MAS. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital” shoqërohet me kodin 71MP0414S, gjithashtu është bërë edhe kodifikimi i lëndëve të këtij programi në sistemin digjital Pitagora. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.25 Ligje, udhezime dhe VKM.pdf - Shtojca 2.15 Kodifikimi i programit te studimit.pdf
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në bazë të dokumentacionit (UMASR nr. 338, datë 17.09.2021) të shqyrtuar GVJ konkludon se ky program studimi nuk është një program i përbashkët midis UNIKO dhe ndonjë IAL tjetër vendas ose të huaj. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.36 Urdher i hapjes se programit te studimit MD.pdf
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Marketingu Digjital” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.

	<i>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor GVJ konstaton se tërësia e lëndëve në këtë program studimi mundëson arritjen e objektivave të programit i cili synon të zhvillojë njohuri të avancuara dhe kompetenca në fushën e marketingut, duke u përqëndruar në menaxhimin e marketingut online, analizën e të dhënave digjitale, strategjitë e reklamimit online, përdorimin e platformave të reja teknologjike, thellimin e njohurive teorike të fituara në ciklin e parë të studimeve, zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive analitike për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve marketing.</i> <i>Bazuar tek plani mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</i> <i>UNIKO është Institucion i Arsimit të Lartë Publik që financohet nga shteti dhe nga burime të tjera të ligjshme. Veprimtaria e UNIKO bazohet në Kushtetutën e RSH, LAL 80/2015, si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, në Statutin e institucionit, si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendëshme, të miratuara apo të dala në zbatim të Statutit. Në Rregulloren e programit janë të përcaktuara qartë kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi.</i> <i>Institucioni ka hartuar dhe propozuar kodifikimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Marketingu Digjital" në përputhje me VKM nr. 310, datë 11.5.2022 dhe fushën e studimit të këtij programi, si dhe ka dërguar propozimin dhe argumentimin për kodifikimin e programit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	Programi i studimit Master Profesional në "Marketingu Digjital" ofrohet nga Departamenti Marketing - Turizëm në Fakultetin e




për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Ekonomisë, në UNIKO. Mbështetur në kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, GVJ konfirmon se Fakulteti i Ekonomisë, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë:

- Departamenti i Marketing – Turizmit;
- Departamenti i Menaxhimit;
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit;

Për vitin akademik 2024-2025 Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij (Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1):

Fakulteti i Ekonomisë	2024-2025	
	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	-
Prof. Asoc. Dr	14	-
Dr.	15	3
Dr. në proces	2	-
MSc	-	1
Total	31	4


Departamenti Marketing - Turizëm, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (minimumi 7 PAE nga të cilët të paktën 3 me tituj/gradë).

Bazuar tek Tabelat Përmbledhëse (Tabela 2), të dhënat analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit Marketing - Turizëm në 3 vitet e fundit janë si më poshtë:

Departamenti	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Marketing - Turizëm						
Prof. Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc. Dr.	5	-	5	-	5	-
Dr.	5	-	4	1	4	-
Dr. në proces	-	-	-	-	-	-

	<table><tr><td>MSc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Total</td><td>10</td><td>0</td><td>9</td><td>1</td><td>9</td><td>0</td></tr></table>	MSc	-	-	-	-	-	-	Total	10	0	9	1	9	0
MSc	-	-	-	-	-	-									
Total	10	0	9	1	9	0									
	Duke ju referuar tabelës së mësipërme GVJ konstaton që departamenti përgjegjës për këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore për organizimin dhe strukturën. Përsa i përket procesit të akreditimit, Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO ka kryer procesin e akreditimit dhe vlerësimit për 5 programe në përputhje me kërkesat e ASCAL dhe është në proces akreditimi për gjithë programet e tjera. Programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” është licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 388, datë 19.07.2021 dhe ky është akreditimi i tij parë. <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - https://unkorce.edu.al/ - https://unkorce.edu.al/departamenti-i-marketing-turizem/														
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar tek programet lëndore (Shtojca 1.32), si dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion në takimin me pedagogët dhe përgjegjësin e departamentit, konstatohet se praktikantët mësimorë që lidhen sidomos me lëndët CRM elektronike, SIM, Dizajni dhe Zhvillimi i Website-ve, Mediat Sociale, etj, zhvillohen në laboratorët e informatikës, dhe mbulohen nga stafi akademik sipas lëndëve përkatëse. Institucioni gjithashtu ka angazhuar një anëtar si personel ndihmës akademik (Tabelat Përmbledhëse: Tabela 2), me përvojë të gjatë pune dhe kualifikimin e duhur për të qenë mbështetës në realizimin e detyrave që lidhen me mësimdhënien dhe praktikantët mësimorë. <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf														

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaton se Departamenti Marketing – Turizëm që është përgjegjës për këtë program studimi, ka zgjedhur një nga pedagogët efektivë si koordinatorin e këtij programi studimi. Koordinatori është caktuar me Vendim të Përgjegjësit të Departamentit, Nr. 368, datë 09.09.2021. Detyrat e koordinorit janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit Marketing – Turizëm Neni 9. Këtu është përcaktuar qartësisht roli i koordinorit, ku midis të tjerave ai ndjek zhvillimin e praktikave mësimore/profesionale dhe është përgjegjës për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuar në syllabusin përkatës, mban kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe me titullarin e njësisë bazë. <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.8 Vendim per percaktimin e koordinatorëve.pdf - Shtojca 1.46 Rregullore e DMT			
Konkluzione	<i>Duke ju referuar të dhënave në tabelat përmbledhëse GVJ konstaton që Fakulteti i Ekonomisë si dhe Departamenti Marketing – Turizëm, të cilët ofrojnë këtë program studimi përmbushin kërkesat ligjore në lidhje me organizimin dhe strukturën e tyre.</i> <i>Përsa i përket procesit të akreditimit, Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO ka kryer procesin e akreditimit për 5 programe dhe është në proces për gjithë programet e tjera. Programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” është në procesin e akreditimit për herë të parë.</i> <i>Departamenti Marketing - Turizëm ka angazhuar një anëtar si personel ndihmës akademik me përvojë të gjatë pune dhe kualifikimin e duhur për të qenë mbështetës në realizimin e detyrave që lidhen me mësimdhënien dhe praktikën mësimore.</i> <i>Departamenti Marketing – Turizëm ka zgjedhur një nga pedagogët efektivë si koordinatorin e këtij programi studimi. Detyrat e koordinorit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X





Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se informacionet për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” janë të përshkruara në dokumentat bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit Marketing – Turizëm, të tilla si Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Programit të Studimit, Plani Mësimor, Programet Lëndore. Gjithashtu informacionet për strukturën dhe përmbajtjen e programit janë publike dhe të aksesohen lirisht edhe nëpërmjet faqes së internetit të institucionit. Gjithashtu bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit pasi informohen që në fillim të studimeve nga koordinatori i programit, por edhe në fillim të çdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.46 Rregullore e DMT - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.34 Rregullore e Brendshme e FE.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf - https://unkorce.edu.al/departamenti-i-marketing-turizem/
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të	Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” përmban planin mësimor të detajuar dhe atë të ndarë sipas veprimtarive formuese, të hartuar në përputhje me kërkesat ligjore. GVJ konfirmon se plani mësimor përmban ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të çdo lënde, sasinë e orëve të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, projekteve, praktikës dhe orët jashtë auditorit, numrin e orëve në auditor gjatë

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	një javë, strukturën e semestrit në lidhje me javët e mësimi, të praktikës, provimit dhe diplomës në fund të semestrit të dytë. Gjithashtu edhe kreditet për çdo lëndë dhe kategorinë ku ajo bën pjesë. Një detajim më i hollësishëm i këtyre elementëve paraqitet edhe në programet lëndore. <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.1 Planet mesimore te MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë paraqiten në Nenin 44 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë si dhe në Nenin 24 të Rregullores së Departamentit Marketing – Turizëm. Përsa i përket kriterëve specifike të pranimeve në këtë program studimi, ato janë të paraqitura në Rregulloren e Progarmit të Studimit “Marketingu Digjital” pika 8. Pranimet në këtë program bëhen me vendim të Senatit Akademik në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akdemike dhe infrastrukurore të miratuara nga MAS (Raporti i Kontrollit të MAS). Përsa i përket transferimit të studimeve, njohjes së krediteve dhe ekuivalentimit të tyre, ato janë të përcaktuara në Kreun XI të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Kreun X të Rregullores së Departamentit Marketing – Turizëm. GVJ shqyrtoi gjithashtu edhe Tabelat Përmbledhëse të RVB, Tabelën 21 dhe konstaton për tre vitet e fundit specifikisht regjistrimet dhe transferimet janë: Master Profesional në “Marketingu Digjital“ - 2022-2023: regjistrime 15 / transferime 0 / Total 15; - 2023-2024: regjistrime 10 / transferime 1 / Total 9; - 2024-2025: regjistrime 15 / transferime 0 / Total 15; <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.46 Rregullore e DMT

	- Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.34 Rregullore e Brendshme e FE.pdf - https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimi-2/ - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.15 Raport i kontrollit të MAS per kapacitete pritese.pdf
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Referuar planit mësimor të programit të studimit (Shtojca 2.1) si dhe programeve lëndore (Shtojca 1.32), GVJ konstaton se ato përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me praktikën në auditor, orët e seminarit, orët e laboratorit dhe orët e studimit individual. Të gjithë këta elementë janë në përputhje me udhëzimet e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Programet lëndore përmbajnë në faqen e parë të dhëna të përgjithshme për lëndën si: titullarin, tipologjinë, semestrin, orët totale në auditor dhe jashtë auditori, gjuhën, llojin e lëndës, sasinë totale të orëve të leksionit dhe seminareve, orët e pavarura që i duhen studentit për aktivitetet e ndryshme të lëndës, formën e kontrollit të dijeve, pikët sipas aktiviteteve, pikët e provimit final të ndara sipas pjesës praktike dhe teorike të lëndës. Gjithashtu programi lëndor përmban një përmbledhje të lëndës, rezultatet e të nxënës, literaturën, dhe në mënyrë të detajuar temat sipas javëve mësimore dhe ngarkesën e tyre. GVJ konkludon se ky program studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore në përputhje me formatet e miratuara. <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.1 Planet mesimore të MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe	Gjatë takimit në institucion me Përgjegjësin e Departamentit Marketing - Turizëm, si dhe pedagogët e lëndëve, GVJ u informua se përmbajtja e programit të studimit Master Profesional "Marketingu Digjital" rishikohet çdo fillim viti akademik për vetë natyrën dhe dinamikën gjithnjë në zhvillim të kësaj fushe. Ndryshimet brenda kufirit të 20% propozohen nga Departamenti përgjegjës për t'ju përshtatur nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve të fundit teknologjike. Ato përcillen në




arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Dekanat nga Përgjegjësi i Departamentit dhe më pas miratohen nga Senati Akademik. GVJ shqyrtoi gjithashtu edhe Tabelat Përmbledhëse të RVB, përkatësisht Tabela 11 paraqet ndryshimet që ka pësuar ngarkesa e disa lëndëve të këtij programi studimi për tre vitet e fundit. <i>Përsa i përket arkivimit të dosjes në gjuhën angleze, GVJ nuk gjen ndonjë dokument për të konfirmuar këtë gjë.</i> <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 2.10 Ndryshimet ne planet mesimore.pdf			
Konkluzione	GVJ konfirmon se informacionet për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional "Marketingu Digjital" janë të përshkruara në dokumentat bazë të FE dhe DMT, të tilla si Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Programit të Studimit, Plani Mësimor, Programet Lëndore. GVJ konstaton se programi i studimit përmban planin mësimor të detajuar dhe atë të ndarë sipas veprimtarive formuese, të hartuar në përputhje me kërkesat ligjore. Rregullorja e FE dhe e DMT përcakton kriteret e përgjithëshme të pranimit të studentëve, kurse kriteret specifike përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit "Marketingu Digjital". Gjithashtu në Rregulloret e FE dhe DMT përcaktohen edhe procedurat për transferimet dhe ekuivalentimin e krediteve. GVJ konstaton se programet lëndore përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me praktikën në auditor, orët e seminarit, orët e laboratorit dhe orët e studimit individual, në përputhje me udhëzimet në fuqi. GVJ konstaton se Departamenti Marketing – Turizëm e rishikon përmbajtjen e programit çdo vit akademik për ta përshtatur atë me kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet përcillen në Dekanat dhe miratohen nga Senati Akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Sipas Rregullores së programit të studimit (Shtojca 1.28) ky program ka si qëllim përgatitjen e studentëve me aftësi dhe njohuri të avancuara mbi konceptet, teoritë dhe praktikat kryesore të marketingut digjital, duke vazhduar thellimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve sidomos në fushën e marketingut. GJV konfirmon që emërtimi dhe përmbajtja e këtij programi studimi e mbështet këtë qëllim. Mbështetur tek Plani Mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital”, shohim që lëndët janë të shpërndara në 5 tipe veprimtarish: Lëndë Bazë; Lëndë Karakterizuese, Lëndë Ndërdisciplinore, Lëndë Plotësuese, Diploma (Shtojca 2.1). Peshën kryesore në program e zënë lëndët karakterizuese me 40% të krediteve, të tilla si Bazat e Marketingut Digjital, CRM Elektronike, Dizajni dhe Zhvillimi i Website-it, Strategjitë e Marketingut Digjital, Performanca e Marketingut Digjital. Kjo shpërndarje i jep mundësinë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme që nga ato bazë tek njohuritë më të thelluara, kryesisht të përqëndruara tek praktika dhe lidhja me tregun e punës. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesomore te MD.pdf
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GJV konstaton se në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë objektivat formuese të programit dhe rezultatet e të nxënit që synohet të kenë studentët nga ky program (Shtojca 1.28). Sipas Rregullores programi i studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” ka si objektiva kryesore: • Ofrimin e njohurive të avancuara mbi konceptet, teoritë dhe praktikat kryesore të marketingut digjital; • Thellimin e njohurive teorike të fituara në ciklin e parë të studimeve në fushën e marketingut;

	• Zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive analitike, për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve marketing; • Përgatitjen e menaxherëve të suksesshëm me aftësitë e nevojshme profesionale për të menaxhuar faqet elektronike; • Zhvillimin e profesionistëve marketerë digjitalë në përputhje me kushtet e reja ekonomiko-shoqërore në tregun vendas dhe ndërkombëtar; Këto objektiva përmbushen duke marrë në konsideratë shpërndarjen e lëndëve sipas kategorive formuese (Plani Mësimor: Shtojca 2.1). Siç e cilësuam edhe në kriterin 1 të këtij standardi, kjo ndarje shërben për plotësimin e objektivave formuese dhe përvetësimin e rezultateve të të nxënit. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesomore te MD.pdf
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ pasi shqyrtoi Planin Mësimor si dhe programet e lëndëve të ofruara në programin e studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital”, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i lëndëve paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, si dhe me programe studimi në vend në të njëjtën fushë. Ky program studimi është organizuar në përputhje me udhëzimet dhe kriteret ligjore duke respektuar ndarjen në kategoritë formuese dhe peshën e secilës kategori. Bazuar tek Plani Mësimor, GVJ konstaton se shpërndarja e orëve mësimore për çdo lëndë është midis leksioneve dhe seminareve. GVJ nuk evidenton një shpërndarje më të detajuar të orëve për të gjykuar mbi raportin teori/praktikë për secilën lëndë. Megjithatë duke bërë një analizë më të detajuar të programeve lëndore, GVJ konstaton se orët e seminareve përfshijnë edhe seanca praktike të cilat janë në përputhje me profilin e këtij programi duke i siguruar studentëve kompetenca profesionale. GVJ rekomandon një përcaktim më të qartë të ndarjes së orëve të seminareve në lidhje me orët e praktikës, orë latoratori apo

	<i>ushtrime, sipas specifikave të lëndëve në mënyrë që të jenë më të orjentuara drejt kompetencave profesionale.</i> Sipas Planit Mësimor, lënda Praktika Profesionale është konceptuar në semestrin e dytë, për një periudhë 2 javore dhe përfshin 50 orë jashtë auditorit. Duke marrë në konsideratë sasinë e orëve jashtë auditorit në një total prej 880 orësh, dhe peshës që zë praktika në këtë total afërsisht 6%, <i>GVJ është i mendimit që është e nevojëshme që të rritet sasia e orëve të praktikës dhe si rrjedhim edhe peshë e saj në formimin e studentëve.</i> <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesomore te MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përsa i përket strukturës së programit, peshën më të madhe e zënë lëndët karakterizuese (Shtojca 2.1): - Kategoria A: Lëndët Bazë kanë 8.3% të totalit të krediteve; - Kategoria B: Lëndët Karakterizuese kanë 40% të totalit të krediteve; - Kategoria C: Lëndët Ndërdisiplinore kanë 30% të totalit të krediteve; - Kategoria D: Lëndët Plotësuese kanë 10% të totalit të krediteve ; - Kategoria E: Detyrimet Përmbyllëse kanë 11.7% të totalit të krediteve; Këto lëndë me njohuritë që ofrojnë e përgatisin studentin për tregun e punës në këto specialitete (Shtojca 1.28): - Menaxher i marketingut digjital; - Specialist SEO; - Menaxher i mediave sociale; - Analist i të dhënave marketing; - Menaxher i përmbajtjes digjitale; - Menaxher i reklamave në Google/Facebook;

	- Ekspert i marketingut të automatizuar; - Konsulet marketingu digjital; - Menaxher i markës digjitale; - Specialist i marketingut të influencuesve; Në tabelën 13 të Tabelave Përmbledhëse si dhe Pikën 13 të Rregullores së programit, gjendet informacion në shkallë të përmbledhur në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit Master Profesionale në “Marketingu Digjital”. Nga kjo tabelë shohim elementet e mëposhtme të ngarkesës totale: - Leksione / Seminare 385 orë; - Seminare 235 orë; - Ushtrime / Laboratore - orë; - Praktika në auditor - orë; - Praktikë profesionale 50 orë jashtë auditori; - Diploma / Provim Formimi 175 orë jashtë auditori; Totali 620 orë në auditor Sikurse e kemi evidentuar edhe në kriteret më sipër të këtij standardi, ndarja sipas kategorive formuese është në përputhje me kërkesat ligjore. Përmbajtja dhe formimi që ofrojnë lëndët mundëson përgatitjen e studentëve në specialitetet e përcaktuar në Rregulloren e programit, si dhe transferimin e studentëve në programe të ngjashme ose dhe në bursa mobiliteti. Kjo mbështetet edhe në faktin që Departamenti Marketing – Turizëm ka pasur raste të mobilitetit të studentëve në universitetet partnere jashtë vendit (Shtojca 3.8). <i>Megjithatë sikurse e kemi cilësuar edhe në kriterin 4 të këtij standardi, GVJ rekomandon një evidentim më të qartë të orëve të praktikës dhe rritjen e peshës së tyre në totalin e orëve që ofron ky program studimi.</i> <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesomore te MD.pdf - Tabela Perfundimtare MD.pdf
--	--

	- <i>Shtojca 3.8 Mobilitette te stafit dhe studenteve.pdf</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Mbështetur tek informacioni i marrë në institucion me Përgjegjësin e Departamentit Marketing – Turizëm si dhe takimi me stafin akademik, GVJ konkludon se syllabuset e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” rishikohen çdo fillim viti akademik. Ato rishikohen në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë e mësimdhënies, rezultatet e të nxëniet, kontrollin e njohurive, literaturën, etj. Të gjithë këta elementë synojnë në ofrimin e kompetencave të nevojshme në përputhje me kërkesat e tregut. Gjithashtu ndryshime janë bërë edhe në lidhje me sasinë e orëve që kanë pasur lëndë të ndryshme ose semestri ku ato zhvillohen (Tabela 11 në tabelat përmbledhëse). <i>Megjithatë GVJ konstaton disa raste ku literatura bazë nuk është e përditësuar, dhe rekomandon një vëmendje më të madhe në përditësimin e saj sipas kërkesës për të përfshirë në program literaturën bazë të viteve të fundit.</i> <u>Referenca:</u> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2023-2024.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2022-2023.pdf</i> - <i>Tabela Perfundimtare MD.pdf</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në shqyrtimin e tërësisë së programeve lëndore për të tre vitet e fundit akademike, GVJ arrin në përfundimin se përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve dhe kombinimit të tyre mes kategorive formuese mundëson përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara për një program të ciklit të dytë të studimeve dhe është në përputhje me objektivat e programit. <u>Referenca:</u> - <i>Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2023-2024.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2022-2023.pdf</i>

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke u mbështetur nga sa u tha në kriteret më sipër për vlerësimin e strukturës së programit të studimit, përmbajtjes së programeve lëndore, përzgjedhjes së lëndëve, etj, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” mundëson punësimin e studentëve në specialitetet e përcaktuara në Rregulloren e këtij programi, si dhe i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për t’ju përshtatur kërkesave të tregut të punës. Duke ju referuar Kornizës Shqiptare të Kulifikimeve, ky nivel studimi i lejon gjithashtu studentët të ndjekin programe të tjera studimi të nivelit master ose edhe të bëjnë shkëmbime apo transferim studimesh në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit në të njëjtin nivel.
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon që emërtimi dhe përmbajtja e këtij programi studimi janë në përputhje me objektivat e programit, dhe i japin mundësinë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme që nga ato bazë tek njohuritë më të thelluara, kryesisht të përqëndruara tek praktika dhe lidhja me tregun e punës. Objektivat formuese të programit dhe rezultatet e të nxëniet që synohet të kenë studentët nga ky program janë të përcaktuara qartë. Lëndët ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. GVJ rekomandon një përcaktim më të qartë të ndarjes së orëve të seminareve në lidhje me orët e praktikës, orë latoratori apo ushtrime, sipas specifikave të lëndëve në mënyrë që të jenë më të orjentuara drejt kompetencave profesionale. Gjithashtu rekomandon shtimin e orëve të Praktikës Profesionale.</i> <i>GVJ konkludon se syllabuset e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” rishikohen çdo fillim viti akademik. Megjithatë GVJ konstaton disa raste ku literatura bazë nuk është e përditësuar, dhe rekomandon një vëmendje më të madhe në përditësimin e saj sipas kërkesave për të përfshirë në program literaturën bazë të viteve të fundit.</i> <i>GVJ arrin në përfundimin se përmbajtja e programit të studimit, përse i përket lëndëve dhe kombinimit të tyre mes kategorive formuese mundëson përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara për një program të ciklit të dytë të studimeve dhe është në përputhje me objektivat e programit. GVJ konkludon se ky program ju mundëson punësimin studentëve në specialitetet e përcaktuara në Rregulloren e këtij</i>




	programi, si dhe i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për t'ju përshatur kërkesave të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konstaton se Departamenti Marketing – Turizëm vlerëson kërkesat e tregut të punës për programet e studimit që ai ofron si dhe përshatshmërinë e këtyre programeve me nevojat e tregut. Gjatë vitit të shkuar akademik Departamenti ka realizuar studimin e tregut të punës (Shtojca 1.29) specifikisht për programin Master Profesional në “Marketingu Digjital”, me qëllim identifikimin e tendencave aktuale dhe të ardhme të punësimit, aftësive dhe kompetencave të kërkuara nga punëdhënësit, si dhe të sfidave dhe mundësive që paraqiten në këtë sektor. Gjithashtu sikurse është evidentuar dhe më parë, përmbajtja e programit rishikohet çdo fillim viti për përmirësime të mundëshme. Nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni, institucioni ndërmerr vazhdimisht aktivitete bashkëpunuese me bizneset dhe organizata të ndryshme të cilat kanë ndikim edhe në përmirësimin e programit të studimit (Plani Vjetor i QKA). <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.29 Studime tregu.pdf - https://unkorce.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni-3/ - https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/PLANI-I-PUNES-VJETOR-2023-2024.pdf
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	Studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit në tërësi, përsa i përket të gjitha aspekteve të mësimdhënies, Nëpërmjet pyetësorit studentor që plotësojnë

tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	studentët çdo semester, vilen mendimet dhe sugjerimet e tyre në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor në tërësi (Shtojca 3.1). Përsa i përket kontaktit dhe konsultimit me studentët e diplomuar, është Qendra e Karrierës dhe Alumni e cila mban kontakte të vazhdueshme me ta, organizon takime dhe analizon opinionet e tyre dhe sugjerimet në lidhje me përshtatshëmrinë e programeve të studimit me tregun. Aktualisht në lidhje me programin e studimit Master Profesional “Marketingu Digjital”, si program i ri që ka pak vite që është hapur, numri i të diplomuarve është ende i vogël 22 studentë dhe numri i të punësuarve në profesion 10 studentë (Tabela 23: Tabelat Përmbledhëse). Megjithatë në takimin me Përgjegjësen e Departamentit Marketing – Turizëm, GVJ u informua që departamenti mban kontakte me ta dhe mendimet dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë. <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.30 Analiza e QKA.pdf - Shtojca 3.1 Modeli i pyetesorit dhe raportit studentor.pdf
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Sikurse e cilësuam edhe në kriterin 1 dhe 2 të këtij standardi, Departamenti Marketing - Turizëm është mbështetur në studimin e tregut dhe analizën e nevojave për profesionistë të kësaj fushe për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij programi (Shtojca 1.29). Një kontribut të drejtpërdrejtë japin aktivitetet e realizuara në kuadër të bashkëpunimeve me partnerët, duke organizuar orë të hapura leksionesh (Shtojca 1.35), tryezash diskutimi, etj, të cilat sjellin tendencat e reja të fushës dhe ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.29 Studime tregu.pdf - Shtojca 1.35 Leksione te hapura.pdf
Konkluzione	GVJ konstaton se Departamenti Marketing – Turizëm vlerëson kërkesat e tregut të punës për programet e studimit që ai ofron si dhe përshtatshëmrinë e këtyre programeve me nevojat e tregut.

	<i>Departamenti Marketing - Turizëm është mbështetur në studimin e tregut dhe analizën e nevojave për profesionistë të kësaj fushe për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij programi.</i> <i>Studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit në tërësi, përsa i përket të gjitha aspekteve të mësimdhënies, Nëpërmjet pyetsorit studentor që plotësojnë studentët çdo semester, vilen mendimet dhe sugjerimet e tyre në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor në tërësi.</i> <i>Qendra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me alumnit, organizon takime dhe analizon opinionet e tyre dhe sugjerimet në lidhje me përshtatshëmrinë e programeve të studimit me tregun.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” ka të përcaktuara qartë në Rregulloren e tij objektivat kryesore të cilat janë: • Ofrimi i njohurive të avancuara mbi konceptet, teoritë dhe praktikatat kryesore të marketingut digjital; • Thellimi i njohurive teorike të fituara në ciklin e parë të studimeve në fushën e marketingut; • Zhvillimi i të menduarit kritik dhe aftësive analitike, për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve marketing; • Përgatitja e menaxherëve të suksesshëm me aftësitë e nevojshme profesionale për të menaxhuar faqet elektronike; • Zhvillimi i profesionistëve marketerë digjitalë në përputhje me kushtet e reja ekonomiko-shoqërore në tregun vendas dhe ndërkombëtar;

	Këto objektiva vijnë në të njëjtën linjë dhe në përputhje me objektivat e institucionit, të përcaktuara në Planin Strategjik 2022-2027 të tij. Në përputhje me këtë strategji, programi mbështet zhvillimin e kërkimeve të aplikuara, duke u përqëndruar tek projektet që lidhen me transformimin digjital dhe analizën e të dhënave për të adresuar sfidat e biznesit. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO.pdf
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti Marketing - Turizëm mbështet personelin akademik në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të tyre. Nga bisedat e zhvilluara në institucion GVJ u informua që personeli akademik mbështetet në përfshirjen e tij në programin e shkëmbimit Erasmus+ (Shtojca 3.8), si dhe në projekte kërkimore-shkencore të financuara nga AKKSHI apo dhe fonde të EU (Shtojca 3.7). Gjithashtu edhe përsa i përket procesit mësimor, departamenti respekton liritë akademike të stafit, duke mbështetur procesin e përmirësimit të programeve lëndore, process që propozohet nga stafi akademik çdo fillim viti dhe miratohet në departament. <u>Referenca:</u> - Shtojca 3.7 Projektet e fituara nga AKKSHI.pdf - Shtojca 3.8 Mobilitette te stafit dhe studenteve.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e studentëve me aftësi dhe njohuri të avancuara për të përballuar sfidat dhe mundësitë e tregut modern digjital, duke luajtur një rol thelbësor në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe duke i mundësuar atyre të aplikojnë strategji të efektshme dhe inovative në profesionet e synuara (Rregullorja e programit). Në këtë kontekst mund të themi që programi është i orientuar më shumë drejt tregut dhe profesionit sesa kërkimit shkencor. Referuar Tabelës 22 (Tabelat Përmbledhëse) nuk ka pasur studentë të përfshirë në aktivitete të kërkimit shkencor të mirfilltë. Por nga ana tjetër mund të themi që studentët inkurajohen nga stafi akademik drejt kërkimit shkencor të

	aplikuar, sidomos në zhvillimin e projekteve të lëndëve dhe diplomës në fund të studimeve të tyre. Gjithashtu konstatohet se institucioni ka organizuar në vitin 2024 konferencën studentore “Transformimi Digjital në Kohën e Sfidave” ku morën pjesë 40 studentë me 23 prezantime. GVJ u informua që ky aktivitet do të pasohet nga konferenca tjetër “Inovacioni Digjital për Zhvillimin e Qëndrueshëm”. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	GVJ u informua gjatë vizitës në institucion me Përgjegjësen e Departamentit Marketing – Turizëm, që institucioni mbështet financiarisht realizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore, si seminare, konferenca, workshop-e. Faqja e web-it të institucionit pasqyron një sërë aktiviteteve shkencore të financuara nga UNIKO. Gjithashtu fondet e përfituara nga projektet e fituara nga AKKSHI apo fondet e EU administrohen nga Departamenti për implementimin e projekteve kërkimore shkencore të fituara. <u>Referenca:</u> - Shtojca 3.7 Projektet e fituara nga AKKSHI.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf - https://unkorce.edu.al/category/kerkimishkencor/projekte/projekte-te-financuara-nga-uniko/
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional “Marketingu Digjital” ka të përcaktuara qartë në Rregulloren e tij objektivat kryesore, të cilat vijnë në të njëjtën linjë dhe në përputhje me objektivat e institucionit, të përcaktuara në Planin Strategjik 2022-2027 të tij. GVJ konstaton se Departamenti Marketing - Turizëm mbështet personelin akademik në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të tyre. Personeli akademik mbështetet në përfshirjen e tij në programin e shkëmbimit Erasmus+ si dhe në projekte kërkimore-shkencore të financuara nga AKKSHI apo dhe fonde të EU.




	<i>Programi është i orientuar më shumë drejt tregut dhe profesionit sesa kërkimit shkencor. Megjithatë mund të themi që studentët inkurajohen nga stafi akademik drejt kërkimit shkencor të aplikuar, sidomos në zhvillimin e projekteve të lëndëve dhe diplomës në fund të studimeve të tyre. Studentët gjithashtu kanë qenë pjesmarrës në Konferencën Studentore, e cila i orjenton ata drejt kërkimit shkencor. Institucioni mbështet financiarisht realizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore, si seminare, konferenca, workshop-e.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Referuar të dhënave në Tabelën 19 “Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik” (Tabelat Përmbledhëse) vëmë re se stafi akademik është aktiv në procesin e kërkimit shkencor, me një pjesmarrje individuale në botime shkencore, pjesmarrje në konferenca, projekte shkencore (Shtojca 3.7), etj. Gjithashtu shohim që edhe departamenti ka organizuar 4 aktivitete shkencore, të cilat mbështesin kërkimin shkencor të stafit akademik, krijojnë rrjetet e bashkëpunimit dhe ndihmojnë edhe në arritjen e objektivave të programit të studimit duke përmirësuar përmbajtjen e tij. <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 3.7 Projektet e fituara nga AKKSHI.pdf
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe	Bazuar tek dokumenti “Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik” (Tabelën 19: Tabelat Përmbledhëse) GVJ konstatoi se ka një angazhim të personelit akademik përgjegjës për këtë program studimi në projekte kërkimore, konferenca dhe botime shkencore. Referuar Tabelës 22 (Tabelat Përmbledhëse) nuk ka

angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	pasur studentë të përfshirë në aktivitete të kërkimit shkencor të mirfilltë, sidomos në projektet e stafit akademik. <i>GVJ rekomandan një angazhim më të madh të studentëve në studime e analiza qoftë edhe të pjesëshme (p.sh. mbledhje të dhënash në anketa studimore, realizim intervistash nëpër biznese, etj.), të cilat mund ti vijnë në ndihmë stafit akademik të përfshirë në projekte konkrete kërkimore – shkencore dhe të jenë të fokusuara tek shërbimi ndaj biznesit dhe industrisë së marketingut.</i> <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga ana tjetër GVJ vlerëson angazhimin e institucioni në organizimin e Konferencave Studentore dhe pjesëmarrjen e studentëve në to. Konferenca e IV studentore e vitit 2024 “Transformimi Digjital në Kohën e Sfidave” lidhet drejtpërdrejt me këtë program studimi dhe është për tu vlerësuar. Gjatë vitit 2025 po planifikohet konferenca me temë “Inovacioni Digjital për Zhvillimin e Qëndrueshëm”. Gjithashtu lista e aktiviteteve të Departamentit Marketing – Turizëm është e bollshme me organizime të shumta qoftë të konferencave për stafin, për studentët, trajnime dhe seminare informuese, etj. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf - https://unkorce.edu.al/konferenca-shkencore-nderkombetare/
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Sikurse e kemi evidentuar dhe në standardet e mësipërme, ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e studentëve me aftësi dhe njohuri të avancuara për të përballuar sfidat dhe mundësitë e tregut modern digjital, duke luajtur një rol thelbësor në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe duke i mundësuar atyre të aplikojnë strategji të efektshme dhe inovative në profesionet e synuara (Rregullorja e programit). GVJ konfirmon që ky qëllim mbështetet më së miri në programet lëndore, të cilat janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut dhe në ngjashmëri me programe të tjera, të të njëjtit lloj, në IAL vendase apo të huaja. Pavarësisht se programi i studimit është akoma i ri në

	tregun rajonal, dhe numri i studentëve të diplomuar është i vogël, përsëri mund të themi se niveli i punësimit është i kënaqshëm dhe gjithashtu përputhshmëria e formimit të të diplomuarve me tregun është e mirë. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore te programit te studimit md.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2022-2023.pdf - Tabela Perfundimtare MD.pdf
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	GVJ u informua në takimin me Përgjegjësen e Departamentit gjatë vizitës në institucion, se FE konakton në mënyrë të vazhdueshme me drejtues të institucioneve publike në të gjithë rajonin e Korçës, por jo vetëm, për të marrë rekomandimet dhe sugjerimet e tyre, në lidhje me kualifikimet që përbëjnë interes të veçantë në fushat që mbulon Departamenti Marketing – Turizëm. Në këtë kuadër janë organizuar edhe tryeza diskutimi, seminare, dhe aktivitete të tjera trajnuese midis Departamentit të Marketing – Turizëm dhe bashkëpunëtorëve të vet. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf - Shtojca 1.35 Leksione te hapura.pdf - Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi te FE dhe DMT.pdf
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	Duke ju referuar dokumentacionit të hapjes së programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital”, GVJ konfirmon se përmbajtja dhe struktura e programit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për nivelin e kualifikimit që ofron (Referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimit). Ky program nuk i përket listës së profesioneve të rregulluara. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.36 Urdher i hapjes se programit te studimit MD.pdf




Konkluzione	<i>Departamenti ka organizuar aktivitete shkencore, të cilat mbështesin kërkimin shkencor të stafit akademik, krijojnë rrjetet e bashkëpunimit dhe ndihmojnë edhe në arritjen e objektivave të programit të studimit duke përmirësuar përmbajtjen e tij. GVJ konfirmon që ka një angazhim të personelit akademik përgjegjës për këtë program studimi në projekte kërkimore, konferenca dhe botime shkencore.</i> <i>GVJ vlerëson angazhimin e institucioni në organizimin e Konferencave Studentore dhe pjesmarrjen e studentëve në to. GVJ konfirmon që qëllimi i programit mbështetet më së miri në programet lëndore, të cilat janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut dhe në ngjashmëri me programe të tjera, të të njëjtit lloj, në IAL vendase apo të huaja.</i> <i>FE kontakton në mënyrë të vazhdueshme me drejtues të institucioneve publike në të gjithë rajonin e Korçës, për të marrë rekomandimet dhe sugjerimet e tyre, në lidhje me kualifikimet që përbëjnë interes të veçantë në fushat që mbulon Departamenti Marketing – Turizëm.</i> <i>GVJ konfirmon se përmbajtja dhe struktura e programit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për nivelin e kualifikimit që ofron.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar tek Tabela 13 në tabelat përmbledhëse të RVB, GVJ konstaton se format e deklaruar të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet dhe seminarët. Përkatesisht programi i studimit ka në total: - 385 orë Leksione; - 235 orë Seminare; - 50 orë Praktikë Profesionale; - 175 orë jashtë auditori; Megjithatë duke bërë një analizë më të detajuar të programeve lëndore, GVJ konstaton se orët e seminareve janë të organizuara në forma të ndryshme, në varësi të natyrës së lëndës ose temës që është zhvilluar në leksion. Ato mund të jenë ushtrime praktike, ndërtim aplikacionesh, trajtim raste studimi, orë laborator, etj. GVJ u informua gjatë vizitës në institucion nga studentët dhe stafi i Departamentit Marketing – Turizëm, që vazhdimisht departamenti zhvillon edhe orë mësimi të hapura në bashkëpunim me ekspertë të fushës së marketingut për të njohur studentët me tendencat e tregut të punës dhe zhvillimin e tij (Shtojca 1.35). <u>Referenca:</u> - Tabela Perfundimtare MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf - Shtojca 1.35 Leksione te hapura.pdf
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personelin akademik dhe me studentët, GVJ konstatoi se personeli akademik përdor larmishmëri të metodave të mësimdhënies, duke kombinuar metodën tradicionale të shpjegimit me analizimin apo aplikimin e rasteve praktike gjatë orëve mësimore, si dhe trajtimin e situatave sa më aktuale në fushën e marketingut digjital. Një praktikë që vlen për tu vlerësuar është edhe aplikimi i vizitave nëpër bizneset që aplikojnë qasjet e fundit të marketingut digjital, duke i njohur studentët direkt me zhvillimet e tregut.




	Po kështu edhe studentët u shprehën në përgjithësi të kënaqur në lidhje me metodat e mësimdhënies që përdorëshin me ta dhe konfirmuan që alternimi i leksioneve me rastet praktike i ndihmonte gjatë studimeve të tyre. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.43 aktivitete te DMT.pdf
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar si dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik, GVJ konfirmon që institucioni mbështet stafin për përmirësimin e kompetencave akademike nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Në këtë kuadër pedagogëve ju është dhënë mundësia nëpërmjet bursave të shkëmbimit Erasmus+, të japim mësim apo të trajnohen në universitete partnere në Evropë (Shtojca 3.8). Gjithashtu Departamenti Marketing – Turizëm ka zhvilluar vazhdimisht aktivitete trajnimi, leksione të hapura, tryeza diskutimi, me ekspertë nga partnerët akademikë ose dhe të biznesit (Shtojca 1.43). Kjo gjë ndihmon personelin akademik të jetë vazhdimisht në kontakt me fushën e praktikës dhe nevojat e tregut për njohuritë dhe kompetencat që ju ofrojnë studentëve. <u>Referenca:</u> - Shtojca 3.8 Mobilitete te stafit dhe studenteve.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te dmt.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.	Mbështetur tek shqyrtimi i dokumentacionit (CV-të e stafit akademik) si dhe të dhënat për kualifikim e stafit përgjegjës për këtë program studimi (Tabelat Përmbledhëse: Tabela 4) GVJ konstaton që kompetenca e personelit konfirmohet nëpërmjet kualifikimeve dhe ekspertizës së tyre. Gjithashtu në takimin me Përgjegjësen e Departamentit Marketing - Turizëm, u informuam që i gjithë stafi është i kualifikuar, mban titullin Profesor i Asociuar ose gradën shkencore Doktor, në përputhje me kërkesat ligjore. Mbështetur edhe tek programet lëndore (Shtojca 1.32), stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, si: diskutimet e hapura, rastet e studimit, ushtrimet aplikative, praktikat profesionale, sjelljen në fokus të zhvillimeve të reja të

Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	teknologjisë në fushën e marketingut digjital; projektet/detyrat e kursit, etj. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se ata kishin vlerësim shumë të mirë për performancën e stafit akademik, duke theksuar mbështetjen e stafit në çdo aspekt që lidhej me procesin mësimor. <u>Referenca:</u> - <i>Tabela Perfundimtare MD.pdf</i> - <i>Shtojca 2.9 CV e stafit akademik.pdf</i> - <i>Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf</i> - <i>Shtojca 4.8 Niveli i kualifikimit te stafit akademikk.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke marrë në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e tyre. Nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizohet shpërndarja e pyetsorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Të dhënat përpunohen nga njësia, analizohen dhe prezantohen nëpërmjet “Raportit të Analizës së të Dhënave të Pyetsorit Studentor për Cilësinë e Mësimdhënies” (Shtojca 3.1). Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, edhe vetë pedagogët shpërndajnë një pyetsor për studentët në përfundim të kursit, me qëllim vjeljen e opinionit të tyre për përmbushjen e objektivave të lëndës dhe përmirësimin e vazhdueshëm. <u>Referenca:</u> - <i>Shtojca 3.1 Modeli i pyetesorit dhe raportit studentor.pdf</i> - <i>Shtojca 2.16 Model pyetesori funfkursi.pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe	GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Struktura kryesore në nivel institucional është Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila krijohet me vendim të Senatit Akademik (Shtojca 1.44). Gjithashtu çdo fakultet ngre NJSBC e vet me propozim të Dekanit. NJSBC në nivel institucional ka nga një përfaqësues koordinator të çdo NJSBC në nivel fakulteti. Pranë çdo njësie kryesore ngrihet edhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm me përfaqësim nga çdo njësi bazë dhe nga organizmat studentore (Statuti i UNIKO). Këto struktura vlerësojnë në mënyrë

njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	periodike veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe propozojnë ndryshime për përmirësimin e tyre. Përsa i përket trajnimit të presonelit akademik në përmirësim të metodave të mësimdhënies, sikurse është evidentuar edhe në Kriterin 3 të këtij standardi, konstatohet se stafi është angazhuar në trajnime dhe aktivitete të tjera bashkëpunimi në kuadër të partneriteteve, por këto janë iniciativa të Departamentit Marketing – Turizëm, dhe jo në kuadër të ndonjë plani veprimi të NJSBC. <i>GVJ rekomandon angazhimin e drejtpërdrejtë të NJSBC në një plan konkret në kuadër të trajnimit të stafit për aplikimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.</i> <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.44 Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë UNIKO.pdf - Shtojca 3.8 Mobilitete të stafit dhe studenteve.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete të dmt.pdf
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se format e deklaruara të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet dhe seminarët. Orët e seminareve janë të organizuara në forma të ndryshme, si ushtrime praktike, ndërtim aplikacionesh, trajtim raste studimi, orë laborator, etj. Personeli akademik përdor larmishmëri të metodave të mësimdhënies, duke kombinuar metodën tradicionale të shpjegimit me analizimin apo aplikimin e rasteve praktike gjatë orëve mësimore, si dhe trajtimin e situatave sa më aktuale në fushën e marketingut digjital.</i> <i>Departamenti Marketing – Turizëm ka zhvilluar vazhdimisht aktivitete trajnimi, leksione të hapura, tryeza diskutimi, me eksperient nga partnerët akademikë ose dhe të biznesit.</i> <i>GVJ konstaton që kompetenca e personelit konfirmohet nëpërmjet kualifikimeve dhe ekspertizës së tyre.</i> <i>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke marrë në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e tyre. GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Struktura kryesore në nivel institucional është Njësia për</i>




	<i>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e cila vlerëson në mënyrë periodike veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësimin e tyre.</i> <i>GVJ rekomandon angazhimin e drejtpërdrejtë të NJSBC në një plan konkret në kuadër të trajnimit të stafit për aplikimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se të gjitha rregullat që lidhen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive të studentëve gjenden të detajuara në Rregulloren e UNIKO Kreu VII “Procedurat e vlerësimit të studentëve”. Këtu përcaktohen rregullat e organizimit të provimeve me shkrim ose me gojë, dokumentacioni, organizimi, sistemi i vlerësimit, shpallja e rezultatit, kriteret për kalimin në vitin pasardhës, riprovimet, deri tek diplomimi. Gjithashtu kriteret dhe mënyra e testimit përcaktohen edhe në Rregulloren e Programit të Studimit “Marketingu Digjital”. Sipas kësaj rregulloreje, format kryesore të kontrollit për vlerësimin e njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: testimet me shkrim dhe me gojë, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, punët në grup, prezantimet, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, mbrojtja e temave të diplomave. Në mënyrë më të detajuar mënyra e testimit të njohurive jepet në programet lëndore. Aty jepen të detajuara pikët për vlerësimin e vazhduar gjatë zhvillimit të lëndës, si projektet, detyrat e kursit, testimet e shkurtra, pjesmarrja aktive. Gjithashtu edhe pikët për provimin final si dhe ndarja e pikëve që ka pjesa teorike dhe praktike në të.



	<u>Referenca:</u> - Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit te Studimit MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lendore 2022-2023.pdf
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar tek informacioni i marrë në takimin me studentët dhe pedagogët e programit Master Profesional “Marketingu Digjital”, GVJ konfirmon se në fillim të semestrit, pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabusin e lëndës duke shpjeguar të gjithë elementët përbërës të tij, përfshirë edhe mënyrën e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, kriteret e vlerësimit, detyrimet për pjesmarrjen, numrin e kontrolleve të ndërmjetme, temat e projekteve, etj. Përveç prezantimit që i bëjnë pedagogët, studentët i marrin programet lëndore përmes platformës LMS, në llogaritë personale të cilat mund ti aksesojnë nga faqja e web-it të institucionit. <u>Referenca:</u> - https://unkorce.edu.al/lms-2/
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sikurse u evidentua në kriterin 1 të këtij standardi, për vlerësimin e njohurive të studentëve në këtë program përdoren metoda të ndryshme. Në këtë mënyrë studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat që ka fituar. GVJ u informua nga stafi akademik që ata përdorin testimet me shkrim kryesisht, por me raste edhe me gojë. Vlerësohen prezantimet, puna në grup, provimi final, prezantimet e detyrave dhe projekteve të kursit, prezantimet e praktikave profesionale etj. Në takimin me studentët GVJ u informua që vlerësimi dhe testimi i njohurive të tyre bëhej në mënyra të ndryshme.
Konkluzione	GVJ konstaton se të gjitha rregullat që lidhen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive të studentëve gjenden të detajuara në Rregulloren e UNIKO Kreu VII “Procedurat e vlerësimit të studentëve”. Në mënyrë më të detajuar mënyra e testimit të njohurive jepet në programet lëndore.

	GVJ konfirmon se në fillim të semestrit, pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabusin e lëndës duke shpjeguar të gjithë elementët përbërës të tij, përfshirë edhe mënyrën e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, kriteret e vlerësimit, detyrimet për pjesmarrjen, numrin e kontrolleve të ndërmjetme, temat e projekteve, etj. GVJ konfirmon se për vlerësimin e njohurive të studentëve në këtë program përdoren metoda të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sikurse u evidentua edhe në standardin 3.2, rregullat që lidhen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive të studentëve në këtë program studimi janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit “Marketingu Digjital”. Në mënyrë më të detajuar mënyra e testimit të njohurive jepet në programet lëndore, të hartuara nga titullari i lëndës dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm (Neni 76 Rregullore e FE). Studentët janë të njohur me këtë mënyrë kontrolli dhe vlerësimi që në fillim të semestrit. Në përgjithësi nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm: a. Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrje aktive (5%-10%); b. Detyra laborator / kursi: (10%-20%); c. Testime gjatë vitit (10%-20%); d. Provimi përfundimtar (70%); <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf




	- Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ konfirmon se institucioni ka nënshkruar një marrëveshje me AADF dhe READ, për vënien në funksion të sistemit elektronike të testimit dhe vlerësimit. Nëpërmjet këtij sistemi synohet të eliminohet çdo formë abuzimi dhe të rritet transparenca në procesin e testimit dhe vlerësimit të studentëve. Në takimin me studentët dhe pedagogët në institucion GVJ u informua se kjo metodë inovative ishte e pëlqyer dhe lehtësuese të për gjitha palët. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale.pdf - Shtojca 6.6 Raporti i implementimit të Cleanscore.pdf
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Sikurse u evidentua në kriterin 1, në përputhje me programet lëndore, në këtë program studimi përdoren metoda të ndryshme për vlerësimin e vazhduar të njohurive të studentëve. Në këtë mënyrë studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat që ka fituar përgjatë semestrit në çdo lëndë. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata ishin të kënaqur me këtë shpërndarje të peshës së vlerësimit nëpërmjet detyrave të kursit, seminareve, quizeve, dhe provimit përfundimtar. Ata konfirmuan se vlerësimi bëhej në përputhje me syllabusin.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë Kreu X janë përcaktuar qartësisht rregullat për vlerësimin e dijeve të studentëve, format e vlerësimit, njohja me rezultatin, procedura e ankimimit, etj. GVJ u informua në takimin me studentët se këto rregulla ishin të njohura edhe prej tyre. Ata konfirmuan gjithashtu që pas marrjes së notës së provimit, nëse ata kishin pyetje apo paqartësi në lidhje me korrigjimin dhe vlerësimin e testimeve, pedagogët ishin të hapur për komente dhe feedback ndaj tyre. Ata u shprehën se stafi akademik ju mundësonte ballafaqimin e vlerësimeve dhe bënte takime me studentët, pas shpalljes së notave, ku studentët kanë të drejtën të shohin provimet e tyre. Ata u shprehën se në çdo rast, merrnin

	argumenta për pikët e marra nga ana e pedagogëve, si dhe këshilla për pikat ku kishin nevojë të përmirësoheshin. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulla të cilat synojnë shmangien e kopjimit si në detyrat gjatë vitit dhe në provime duke përcaktuar edhe saksionet në rastet e shkeljes së etikës nga çdo student. Studentët janë të njohur me këto rregulla. Sipas Rregullores studenti që përdor në provim forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi (Neni 76 Rregullore e FE). <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se Rregullorja e FE përcakton në Nenin 84 afatet e komunikimit të rezultateve të provimit për studentët. Deri 8 ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në Sektorin e Studimeve dhe në Sektorin e TIK-ut pasqyrën e rezultateve të provimit. Në takimin me studentët u informuam që ata i kishin marrë rezultatet në kohë, sipas afateve të përcaktuara në Rregullore. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E drejta e studentit për tu njohur me vlerësimin, për të bërë kërkesë për rishikim, ankimim të vlerësimit apo procedurës së provimit përcaktohet në Rregulloren e UNIKO Neni 83, si dhe në Rregulloren e FE Neni 85. Rregullorja përcakton që rezultatin paraprak studenti e merr pas 6 ditësh së provimit, dhe ka 2 ditë kohë për ankimim. Kërkesat i shqyrton dekan i cili ja përcjell departamentit kur e gjykon se kërkesa është e drejtë. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ata nuk kishin pasur raste të ankimeve të rezultateve të tyre në dekanat. <u>Referenca:</u>

	- Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf - Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sikurse u cilësua në kriterin më sipër, e drejta e ankimimit dhe shqyrtimi i saj përcaktohen në rregulloret e institucionit. Ankesa shqyrtohet nga Dekani, i cili thërret për sqarime përgjegjës të departamentit, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Pra në këtë mënyrë ndiqet një procedurë transparente për të gjitha palët e përfshira. Dekani përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë mbahet në Dekanat. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO
Konkluzione	GVJ konfirmon që vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Studentët janë të njohur me këtë mënyrë kontrolli dhe vlerësimi që në fillim të semestrit. Institucioni ka nënshkruar një marrëveshje me AADF dhe READ, për vënien në funksion të sistemit elektronik të testimit dhe vlerësimit. Studentët konfirmuan se vlerësimi bëhet në përputhje me syllabusin. Ata konfirmuan gjithashtu që pas marrjes së notës së provimit, nëse ata kishin pyetje apo paqartësi në lidhje me korrigjimin dhe vlerësimin e testimeve, pedagogët ishin të hapur për komente dhe feedback ndaj tyre. E drejta e studentit për tu njohur me vlerësimin, për të bërë kërkesë për rishikim, ankimim të vlerësimit apo procedurës së provimit përcaktohet në Rregulloret e institucionit. Rregullorja përcakton që rezultatin paraprak studentit e merr pas 6 ditësh së provimit, dhe ka 2 ditë kohë për ankimim. Deri 8 ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon




	online dhe dorëzon në Sektorin e Studimeve dhe në Sektorin e TIK-ut pasqyrën e rezultateve të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Sipas Rregullores së programit të studimit, qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” është përgatitja e studentëve me aftësi dhe njohuri të avancuara për të përballuar sfidat dhe mundësitë e tregut modern digjital. Gjithashtu ai luan një rol në zhvillimin e aftësive praktike, si analizimi i të dhënave, menaxhimi i fushatave digjitale dhe përdorimi i mjeteve të teknologjisë, i mediave digjitale, përmbajtjes digjitale, optimizimin e motorëve të kërkimit, etj. Për realizimin e këtij qëllimi programi mbështetet në një kombinim lëndësh midis fushës së marketingut dhe teknologjisë, të tilla si Strategjitë e Marketingut Digjital, CRM Elektronike, Dizënjimi dhe Zhvillimi i Website-ve, etj. Mbështetur tek ky kombinim lëndësh si dhe kombinimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, programi garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale për studentët. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Ky program studimi është i lidhur ngushtësisht me teknologjinë e informacionit për vetë fushën e studimit ku ai mbështetet. Ai synon të pajisë studentët me njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjive të fundit për analizën e të dhënave dhe matjen e

teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	performancës marketing por ai fokusohet edhe në zhvillimin e aftësive për të patur një komunikim efektiv dhe bashkëpunim ndërkulturor. Metodat e ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive inkurajojnë studentët për pjesmarrje në diskutime, analiza raste studimi, etj. Gjithashtu studentët janë të inkurajuar të zhvillojnë aftësi në gjuhë të huaj, veçanërisht në anglisht, e cila është thelbësore për të përvetësuar literaturën ndërkombëtare dhe për të komunikuar në mënyrë efektive në tregjet globale. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf - Raporti MD.pdf
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar tek dokumentet e shqyrtuara (Programet Lëndore) një nga rubrikat e përfshira në syllabuset e lëndëve është “Përshkrimi i lëndës” dhe “Rezultatet e të nxëniet të lëndës” ku paraqiten njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës. Nga diskutimi me studentët dhe pedagogët, GVJ u informua se studentët njihen me këto në fillim të semestrit gjatë prezantimit të syllabusit, dhe në përfundim të semestrit bëhet një përmbledhje e lëndës ku diskutohen rezultatet e të nxëniet dhe analizohet shkalla e arritjes së tyre. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e	Nga shqyrtimi i programeve lëndore të programit të studimit vëmë re që lëndët zhvillojnë në orët e seminareve edhe seanca praktike të cilat janë në përputhje me profilin e këtij programi duke i siguruar studentëve kompetenca profesionale. Gjithashtu programi parashikon edhe Praktikën, që zhvillohet në semestrin e 2-të e cila parashikon 50 orë në terren, ku studenti aplikon njohuritë e marra në lëndët e ndryshme në institucionin ku ndjek praktikën, si edhe merr eksperiencën profesionale gjithashtu. Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe planit mësimor, evidentohet që metodat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik janë të kombinuara, duke synuar sa më shumë përfshirjen e

problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	studentëve në diskutime dhe punë në grup. Vetë studentët shpreheshin të kënaqur me përdorimin e këtyre metodave duke i konsideruar më motivuese dhe më produktive për të zhvilluar idetë e tyre inovative. Përsa i përket bashkëpunimit me institucione të tjera ndërkombëtare në kuadër të mobilitetit të studentëve, evidentohet se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe inkurajon studentët për mobilitete në universitete të huaja. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2024-2025.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2023-2024.pdf - Shtojca 1.32 Programet lëndore 2022-2023.pdf - Shtojca 2.1 Planet mesomore te MD.pdf - Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale.pdf - Shtojca 3.8 Mobilitette te stafit dhe studenteve.pdf
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti Marketing Turizëm ka zhvilluar një sërë aktivitete me leksione të hapura dhe seminare me të ftuar të ndryshëm, ekspertë të fushës. Gjithashtu nëpërmjet këtyre aktiviteteve organizohen edhe trajnime. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për studentët dhe stafin akademik që të diskutojnë inovacionet më të fundit në teknologjinë e marketingut digjital, analitikën e të dhënave, dhe strategjitë e reklamimit online, duke u mbajtur të përditësuar me tendencat globale në këtë fushë. Gjatë takimit me studentët e këtij programi, ata konfirmuan ndjekjen e këtyre aktiviteteve dhe u shprehën që ato ishin shumë informuese. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.35 Leksione te hapura.pdf - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ konstaton se institucioni inkurajon studentët në aktivitete në të cilat ata shpalosin idetë e tyre inovative dhe orientohen drejt kërkimit shkencor. Institucioni ka organizuar në vitin 2024 konferencën studentore “Transformimi Digjital në Kohën e Sfidave” ku morën pjesë 40 studentë me 23 prezantime. GVJ u informua që ky aktivitet do të pasohet nga konferenca tjetër “Inovacioni Digjital për Zhvillimin e Qëndrueshëm”. GVJ

	konstaton që institucioni mbështet financiarisht realizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore, si seminare, konferenca, workshop-e për studentët dhe pedagogët. Faqja e web-it të institucionit pasqyron një sërë aktiviteteve shkencore të financuara nga UNIKO. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf - https://unkorce.edu.al/category/kerkimishkencor/projekte/projekte-te-financuara-nga-uniko/ - Shtojca 1.43 Aktivitete te DMT.pdf			
Konkluzione	<i>Qëllimi kryesor i programit të studimit është përgatitja e studentëve me aftësi dhe njohuri të avancuara për të përballuar sfidat dhe mundësitë e tregut modern digjital. Për realizimin e këtij qëllimi programi mbështetet në një kombinim lëndësh midis fushës së marketingut dhe teknologjisë. Mbështetur tek ky kombinim lëndësh si dhe kombinimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, programi garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale për studentët.</i> <i>GVJ konfirmon që në përfundim të semestrit bëhet një përmbledhje e lëndës ku diskutohen rezultatet e të nxëniet dhe analizohet shkalla e arritjes së tyre.</i> <i>Lëndët zhvillojnë në orët e seminareve edhe seanca praktike të cilat janë në përputhje me profilin e këtij programi duke i siguruar studentëve kompetenca profesionale.</i> <i>Departamenti Marketing Turizëm ka zhvilluar një sërë aktiviteteve me leksione të hapura dhe seminare me të ftuar të ndryshëm, ekspertë të fushës.</i> <i>Institucioni inkurajon studentët në aktivitete në të cilat ata shpalosin idetë e tyre inovative dhe orientohen drejt kërkimit shkencor duke i mbështetur edhe financiarisht ato.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar procedura të posaçme për detyrimet përmbyllëse të programeve të studimit. Këto procedura përcaktohen në Rregulloren e UNIKO, Rregulloren e FE si dhe specifikisht për këtë program studimi në Rregulloren e Programit të Studimi të MD. Gjithashtu studentëve ju ofrohet informacion i detajuar edhe nëpërmjet një dokumenti të posaçëm “Udhëzues për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës në programin Master Profesional në Marketingu Digjital”. Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës hartohet dhe miratohet nga departamenti në fillimit të vitit akademik. Ky informacion iu vihet në dispozicion studentëve në përfundim të semestrit të parë. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf - Shtojca 2.3 Udhëzuesi i diplomes MD.pdf
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësen e Departamentit Marketing - Turizëm se departamenti i cakton një udhëheqës për diplomim studentit, i cili e ndihmon studentin që në përzgjedhjen e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve, dhe shkrimin e diplomës. Personeli akademik asiston studentët me udhëzime dhe materiale të nevojshme. Sekretaria mësimore, afishon në stendat informuese në mjediset e FE, tabelën përmbledhëse të studentëve dhe pedagogëve udhëheqës së temave të diplomës, datën dhe sallën e mbrojtjes së punimit. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 2.3 Udhëzuesi i diplomes MD.pdf



Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në bazë të Rregullores së Programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital”, detyrimet përmbyllëse në këtë program shlyen vetëm me mbrojtjen e temës së diplomës. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	GVJ konfirmon në bazë të informacionit që mori në takimin me stafin akademik si dhe bazuar tek dokumentat, se pedagogu udhëheqës i temës së diplomës ndihmon studentin gjatë gjithë procesit duke hartuar strukturën, ndihmuar në zgjedhjen e literaturës, përgatitjen e pyetësorit dhe përpunimin e rezultateve. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve në disa takime periodike përgjatë të cilave kontrollohet puna e studentit. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti dhe pedagogu. Para mbrojtjes, udhëheqësi rishikon punimin, dhe garanton cilësinë e tij. <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.3 Udhëzuesi i diplomes MD.pdf
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në mbështetje të studentit, stafi akademik i DMT, monitoron dhe informon studentët për kryerjen e punimit në mjediset e institucionit duke vendosur në dispozicion të gjithë infrastrukturën e tij. Për vetë natyrën e këtij programi ata përdorin kryesisht laboratorët e informatikës, software të ndryshëm specifikë që lidhen me programin e studimit, platformat online për të bërë kërkime të specializuara, etj.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konfirmon se në përfundim të mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi bëhet në përputhje me Rregulloren e FE dhe atë të programit të studimit. Vlerësimi bëhet me notën nga 4 (katër) në 10(dhjetë) sipas sistemit shqiptar të vlerësimit. Në vlerësimin e studentit merren




	parasysh disa komponentë, që nga vlerësimi i udhëheqësit, i komisionit, dhe arritjet akademike të studentit, gjatë ciklit të studimit, etj. <u>Referenca:</u> - Shtojca 1.28 Rregullore e Programit të Studimit MD.pdf - Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE.pdf
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konfirmon që pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, studenti pajiset me diplomë “Master Profesional Marketingu Digjital”. Diploma shoqërohet me suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar nga MAS. Kopja e plotë zyrtare e programit të studimit, e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë i vihet në dispozicion çdo studentit me kërkesën e tij. <u>Referenca:</u> - Shtojca 2.6 Modeli dhe suplementi i diplomes MD.pdf
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit se, të dhënat mbi diplomimin regjistrohen në Regjistrin e Lëshimit të Diplomave dhe Çertifikatave, si dhe në Regjistrin Bazë. Njësia kryesore i ruan të dhënat e mësipërme, në formë elektronike në sistemin Pitagora. Të gjitha të dhënat e studentit që nga arritjet akademike, të dhënat e diplomimit, numri i diplomës, data e diplomimit dhe nota e diplomës, ruhen dhe vihen në dispozicion të studentit me kërkesën e tij. Institucioneve që në formë ligjore drejtojnë kërkesë pranë UNIKO, ju vihen në dispozicion të dhënat e mësipërme, gjithmonë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar procedura të posaçme për detyrimet përmbyllëse të programeve të studimit. Këto procedura përcaktohen në Rregulloren e UNIKO, Rregulloren e FE si dhe specifikisht për këtë program studimi në Rregulloren e Programit të Studimi të MD.</i> <i>Departamenti i cakton një udhëheqës për diplomim studentit, i cili e ndihmon studentin që në përzgjedhjen e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve, dhe shkrimin e diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve në</i>

	disa takime periodike përgjatë të cilave kontrollohet puna e studentit. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë. Pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, studenti pajiset me diplomë "Master Profesional Marketingu Digjital". Të gjitha të dhënat e studentit që nga arritjet akademike, të dhënat e diplomimit, numri i diplomës, data e diplomimit dhe nota e diplomës, ruhen dhe vihen në dispozicion të studentit me kërkesën e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Fakulteti i Ekonomisë i cili është përgjegjës për këtë program studimi ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznese, disa nga të cilat janë të lidhura specifiku për Departamentin Marketing – Turizëm (Shtojca 1.42). Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve institucioni ju mundëson studentëve zhvillimin e praktikës profesionale në mjedise të përshtatshme të orientuara drejt tregut të punës. Përsa i përket mjediseve brenda institucionit, duke ju referuar Tabelës 16 (Tabelat Përmbledhëse) GVJ konstaton se institucioni disponon 1 sallë për praktikë lëndore profesionale dhe 1 sallë laborator informatike. <i>Duke ju referuar specifikeve të këtij programi studimi, i cili është i lidhur ngushtësisht me përdorimin e teknologjisë dhe internetit, si dhe duke marrë në konsideratë numrin e programeve të tjera të studimit që FE ofron, GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve të informatikës për t'ju mundësuar studentëve të programit të studimit Master Profesional "Marketingu Digjital", por jo vetëm, që të aplikojnë njohuritë teorike të marra në leksione në baza praktike, për të qenë më të përgatitur për tregun e punës.</i>

	<i>Referenca:</i> - Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi te FE dhe DMT.pdf - Tabela Perfundimtare MD.pdf
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Sikurse u cilësua edhe në kriterin 1 të këtij standardi UNIKO ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me qëllim realizimin e praktikave të studentëve të të gjitha programeve të studimit që ai ofron. Këto marrëveshje i gjejmë edhe të lidhura specifikisht sipas fakulteteve apo departamenteve duke i lidhur drejtpërdrejt me nevojat specifike të programeve. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve ju mundësohet studentëve qasja e drejtpërdrejtë me tregun e punës, njohja me nevojat që ai ka, si dhe me teknologjitë më të fundit që janë në përdorim. <i>Referenca:</i> - Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi te FE dhe DMT.pdf - Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale.pdf
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Duke ju referuar Planit Mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” konstatojmë se Praktika parashikon që studenti të zhvillojë 50 orë jashtë auditorit dhe në përfundimin me sukses të saj, studenti vlerësohet nga udhëheqësi dhe personi mbikqyrës në institucionin ku zhvillon praktikën, vlerësim i cili ekuivalentohet në 2 kredite (ECTS). E gjithë procedura që ndiqet për zhvillimin e praktikës, paketa e dokumentave, përcaktimi i institucionit bashkëpunues, marrëveshja, skeda e studentit, raporti, formularët e vlerësimit, etj, janë të paraqitura qartësisht në “Udhëzuesin për përgatitjen dhe mbrojtjen e praktikës profesionale të programit të studimit Master Profesional “Marketingu Digjital”. <i>Referenca:</i> - Shtojca 2.1 Planet mesomore te md.pdf - Shtojca 1.45 Udhëzues per raktiken profesionale.pdf
Konkluzione	Fakulteti i Ekonomisë i cili është përgjegjës për këtë program studimi ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznese, disa nga të cilat janë të lidhura specifikisht për Departamentin Marketing – Turizëm.

	GVJ konstaton se institucioni disponon 1 sallë për praktikë/lëndore profesionale dhe 1 sallë laborator informatike. Duke ju referuar specifikave të këtij programi studimi, i cili është i lidhur ngushtësisht me përdorimin e teknologjisë dhe internetit, <u>GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve të informatikës për t'ju mundësuar studentëve të programit të studimit Master Profesional "Marketingu Digjital" të aplikojnë njohuritë teorike të marra në leksione në baza praktike, për të qenë më të përgatitur për tregun e punës.</u> UNIKO ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me qëllim realizimin e praktikave të studentëve. Praktika për këtë program studimi parashikon që studenti të zhvillojë 50 orë jashtë auditorit dhe në përfundimin me sukses të saj, studenti përfiton 2 kredite (ECTS).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit,	GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues i paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion, se personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kuadrin ligjor por edhe me kërkesat bashkëkohore




përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Në përmbajtje të këtij stafi akademik kualifikimi kryesor dominon midis titullit Profesor i Asociuar dhe Doktor i shkencave. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2022- 2025 është si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë nga të cilët të gjithë PAE;
2. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët të gjithë PAE;
3. Për vitin akademik 2024- 2025 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët të gjithë PAE;

Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		2024 - 2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	7	-	6	-	6	-
Dr/PhD	5	-	4	-	4	-
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	12	-	10	-	10	-

Konstatohet gjithashtu se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.

Referenca:



RVB

Tabelat përmbledhëse MD.pdf

Shtojca 4.8 Kualifikimet e stafit akademik të FE

Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të Lartë, Neni 59, pika 8; Udhëzimi Nr. 29 datë 10.09.2018

Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO

	<i>Shtojca 4.4 Modeli i kontratës individuale të punës</i> <i>Vizita në Institucion</i>																				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD, është realizuar në përputhje me kërkesat dhe kuadrit rregullator në fuqi sa i takon raportit të PAE dhe PAK, madje duhet theksuar se, personeli akademik efektiv mbulon afërsisht 100% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi, kjo për faktin se niveli i orëve që mbulohet nga pedagogët efektivë të departamentit të MT është i lartë. Nga ana tjetër u konstatua se pedagogë PAE arrijnë të realizojnë deri në 8 lëndë të cilat në disa raste ku respektivisht Prof. Qirici, ka realizuar 485 orë fizike në auditor të realizuara. Të tjerë kanë realizuar gjithashtu mbi 400 orë fizike në auditor të realizuara gjithashtu me nga shumë lëndë. Gjithashtu edhe disa raste të tjera të cilët rezultojnë të kenë realizuar nga 7 dhe 8 lëndë me mbi 400 orë fizike në auditor. Kjo situatë sidomos e shpërndarjes së lëndëve bie ndesh me Udhëzimin Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot. Pjesa II pika. 6 dhe pika 7. <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>670</td><td>670</td><td>0</td><td>100% / 0 %</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>670</td><td>670</td><td>0</td><td>100% / 0 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>670</td><td>670</td><td>0</td><td>100% / 0 %</td></tr></table> Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. II Ngarkesën Mësimore Vjetore për Personelin Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. Pika 6. Ku thotë: Ngarkesa e plotë mesimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbaje në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	670	670	0	100% / 0 %	2023-2024	670	670	0	100% / 0 %	2024-2025	670	670	0	100% / 0 %
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	670	670	0	100% / 0 %																	
2023-2024	670	670	0	100% / 0 %																	
2024-2025	670	670	0	100% / 0 %																	

	në dy semstre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore. Ndërkohë që kjo shpërndarje dhe ky përqëndrim i lartë i lëndëve në një pedagog në disa raste nuk është as në përputhje me objektivat dhe mundësitë e stafit PAE për të ruajtur cilësinë por edhe për t'u angazhuar me punë kërkimore në ndihmë edhe të rritjes së kualifikimit personal. <i>GVJ rekomandon nga sa më lartë një përmirësim në reduktim të kësaj ngarkese mësimore në auditor. Gjithashtu edhe reduktim të lëndëve që është titullar apo jep mësim një pedagog i departamentit të Marketing Turizmi. Kjo jo vetëm në ndihmë të ruajtjes së cilësisë dhe angazhimit me punë kërkimore në ndihmë edhe të rritjes së kualifikimit personal, por sidomos edhe të respektimit të kuadrit ligjor për numrin e lëndëve që një personel akademik duhet të japë në një semestër apo vit akademik.</i> <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MD.pdf Shtojca 4.8 Kualifikimet e stafit akademik të FE Shtojca 1.25 Ligji I Arsimit të Lartë, Neni 59, pika 8; Udhëzimi Nr. 29 datë 10.09.2018 Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar ne dokumentacionin e DVV por edhe gjithashtu vizitës në institucion UNIKO, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD. Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Stafi ka dëshmuar qëndrueshmëri dhe nuk ka pasur largime apo prurje të reja. <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MD pdf Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 4.4 Modeli i kontratës individuale të punës Shtojca 4.3 Format vendimi komisioni për vlerësimin e kandidatëve.pdf



	<i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ bazuar në RVB por edhe në dokumentacionin bashkangjitur konstaton qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim në UNIKO, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurrim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Konstatohet qartë gjithashtu edhe roli i Senatit Akademik i UNIKO i cili vendos kritere bazë për rekrutimin e personelit, të cilat bëhen publike në çdo konkurs. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 4.3 Format vendimi komisioni për vlerësimin e kandidatëve</i> <i>Shtojca 4.5 Format urdhër emërimi</i> <i>Shtojca 4.6 Kriteret e rekrutimit</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në RVB por edhe në dokumentacionin bashkangjitur, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë respektivisht Departamenti i Marketing Turizmit siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve mbështetur tek rregullorja UNIKO. Zyra e Burimeve Njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të UNIKO, arkivon të dhëna të përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Përditësimi i dokumentacionit bëhet nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit. GVJ konstatoi gjithashtu se dosjet personale disponohen për çdo anëtar të stafit akademik efektiv dhe ndihmës akademik me kontratë që lidhen me karrierën apo titujt akademik. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 4.4 Model i kontratës individuale të punës</i> <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, me përgjegjës Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD. Pas verifikimit në mënyrë rastësore të personelit, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit, mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit. Gjithashtu edhe drejtorja e burimeve njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të UNIKO, arkivon të dhëna të përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit të DMT. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Neni 4, pika c, Neni 5, pika 3 Shtojca 4.7 Aktiviteti kërkimor shkencor i DMT Vizita në Institucion
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO në nivel institucioni por edhe FE dhe DMT kanë nënshkruar 10 marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD, praktika profesionale. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga UNIKO me institucione dhe biznese të Korçës dhe rajonit. GVJ konfirmoi këtë proces dhe nga takimi me studentët e programit gjithashtu edhe me stafin. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. GVJ gjithashtu konstatoi se Drejtuesi i njësisë kryesore në UNIKO mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë pritëse deri një muaj para fillimit të praktikës. <u>Referenca:</u> RVB




	<i>Shtojca 1.41 Marrveshje Institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se praktikat profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga DMT. Gjithashtu personeli akademik i departamentit angazhohet në mbikqyrjen në ambientin pritës si edhe në realizimin e praktikave profesionale të studentëve sipas marrëveshjeve të bëra me UNIKO apo FE që të përmbushin detyrimin e kryerjes së praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës profesionale, personeli mbikqyrës në ambientin ku realizohet praktika profesionale, përpilon një relacion përfundimtar vlerësimi mbi ecurinë dhe arritjet e studentit për kryerjen e praktikës profesionale. E tërë procedure regullohet nga Rregullorja e Njesisë Bazë së Departamentit të Marketing Turizëm. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.45 Udhëzues i Praktikës</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet në përmbushje kryesisht të këtij standardi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në RVB. Departamenti i Marketing Turizëm ka të angazhuar personel akademik për realizimin e programit.</i> <i>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për shpërndarjen e lëndëve nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar. Sipas Evidencave rezultojnë pedagogë me 8 Lëndë të realizuara me një total rreth 485 orësh. Korniza ligjore në fuqi, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot. Dikton numër shumë më të kufizuar lëndësh për pedagog PAE, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të ofruara nga ky staf akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Departamenti i Marketing Turizëm zhvillon procesin mësimorë në godinën e Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin Master Profesional Marketingu Digjital, MP_MD janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Referuar sipërfaqes totale në dispozicion dhe vlerësimeve nga GVJ kapacitetet e plotësojnë normativën mesatare të sipërfaqes së shfrytëzueshme, për student. Përkatësisht, në dispozicion janë: <table><tr><th>Mjedisi - FB</th><th>Nr. Sallash</th></tr><tr><td>Salla leksioni + seminari</td><td>15</td></tr><tr><td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td><td>4</td></tr><tr><td>Zyra për stafin</td><td>13</td></tr><tr><td>Bibliotekë</td><td>1</td></tr><tr><td>Zyra Informacioni per Studentë</td><td>1</td></tr></table> <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MD.pdf Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore Shtojca 1.15 Raport i kontrollit të MAS për kapacitetet pritëse të UNIKO 2023-2024 Vizita në Institucion	Mjedisi - FB	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	15	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4	Zyra për stafin	13	Bibliotekë	1	Zyra Informacioni per Studentë	1
Mjedisi - FB	Nr. Sallash												
Salla leksioni + seminari	15												
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4												
Zyra për stafin	13												
Bibliotekë	1												
Zyra Informacioni per Studentë	1												
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me	Kryesisht gjatë vizitës në IAL, GVJ konstatoi se sallat që përdoren gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik.												

mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë disa prej tyre dhe me pc-kompjuter, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet. Godina e DMT është e pajisur me linjë interneti dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët, krahas rrjetit të internetit (kabllor/lan) funksionon edhe sistemi wireless i internetit, duke iu mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambientet e jashtme. Sallat e konferencave ku zhvillohen aktivitete ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare, të cilat janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë, smartborde, whiteboards. <u>Referenca:</u> Tabelat përmbledhëse MD.pdf Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore Vizita në Institucion
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në vizitën në institucion, por edhe në dokumentacionin e vetëvlerësimit. GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomisë, i cili ofron programin Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD. FE disponon një sallë konferencash ku zhvillohen aktivitete ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare, të pajisur me pajisje kompjuterike, monitor, videoprojektor, etj. FE ofron për studentët laboratorë dhe gjithashtu salla dhe mjedise të tjera të pajisura me mjete brenda standarteve për të përmbushur kërkesat e programit dhe për të arritur objektivat e tij. <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MD.pdf Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas	Fakulteti Ekonomisë, i cili ofron programin Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD ofron për studentët laboratorë të pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme të transferimit të teknologjive, ku studentët kryesisht realizojnë orët e seminareve për këtë program studimi. GVJ është shprehur edhe më sipër rreth nevojës për shtimin e një laboratorit tjetër në funksion të studentëve duke marrë në konsideratë që përdoret

natyrës së programit të studimit që ofron.	nga një numër i lartë studentësh, si dhe për natyrën e këtij programi studimi, është shumë e rëndësishme një laboratorë i tillë. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>Tabelat përmbledhëse MD.pdf</i> <i>Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Bazuar në DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomisë, dhe departamenti i Marketing Turizmit i cili ofron programin Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD ka siguruar 10 marrveshje për bashkëpunim institucional të posaçma vetëm për këtë program studimi. GVJ është shprehur me detaje rreth natyrës së këtyre marrëveshjeve në kriteret me sipër. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>Tabelat përmbledhëse MD.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në vizitën në IAL por edhe në tërë dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar që UNIKO ka në dispozicion të Fakultetit Ekonomisë godinën e cila ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimor.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Gjithashtu UNIKO vë në dispozicion të studentëve informacione on-line nga burime të ndryshme elektronike si ajo. Megjithatë në një numër të lëndësh, në programet respektive vihet re një mungesë e specifikimit të viteve të botimit të literaturës bazë, dhe e asaj të detyrueshme. Në disa raste të tjera lëndësh kjo literaturë bazë rezulton të jetë e pa përditësuar dhe e viteve të fundit. <i>Duke konsideruar natyrën e këtij programi studimi, GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës pasi për disa lëndë raportohet edhe në programet e tyre një literature e pa përditësuar ose e përditësuar në gjuhën angleze sidomos ajo e literaturës së rekomanduar.</i> <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në të dyja biblioteka, si në atë shkencore të UNIKO-s por edhe në atë të Fakultetit të Ekonomisë, raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit.



	Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërndahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve. <i>Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkangjitur RVB_së, kryesisht nga (Programet Lëndore të Lëndëve të Programit MD), konstatohet se në disa lëndë literaturë bazë ose rezulton e pa specifikuar në raport me botimin ose të pa përditësuar me botime të viteve të fundit ose të paspecifikuar viti i botimit.</i> GVJ konstatoi gjithashtu nga dokumentacionin në dispozicion se UNIKO ka ndërmarrë masa për shtimin e fondit të bibliotekës në në përgjigje të kërkesave të pedagogëve si edhe nevojave të njësisë bazë. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.32 Programet Lëndore Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UNIKO dhe FE vë në dispozicion të studentëve dhe stafit një fond të përgjithshëm i cili arrin 5316 libra dhe 3610 tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 6 kompjuterash dhe 80 vende studimi. <i>GVJ rekomandon rritjen e aksesueshmërisë me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur nga fakti se në programin e studimit MD, në një pjesë të mirë të programeve të lëndëve rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit megjithëse në gjuhë huaj. Nevojë kjo e cila nxit frekuentim e bibliotekës elektronike më shumë.</i> <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.32 Programet Lëndore Shtojca 3.5 Biblioteka Vizita në Institucion

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksoj edhe ne kriterin 3, se biblioteka disponon dhe një fond të përgjithshëm i cili arrin 5316 libra dhe 3610 tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 6 kompjuterash dhe 80 vende studimi. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.5 Biblioteka Vizita në Institucion
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programin Master Profesional në Marketingu Digjital, që UNIKO ofron për të gjithë dhe pa pagesë bibliotekën online. Biblioteka ofron informacione online nga burime të ndryshme elektronike. Biblioteka Shkencore e UNIKO, duke qënë anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, ka siguruar akses në burime të ndryshme elektronike, informacione të cilat mund të shfrytëzohen nga çdo student dhe pa pagesë. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.5 Biblioteka Vizita në Institucion
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Master Profesional në Marketingu Digjital, se Bibliotekat e Fakultetit ofron informacione online nga burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë. Biblioteka shkencore e UNIKO dhe biblioteka e FE funksionojnë me salla studimi dhe të pajisura me 8 kompjutera (internet) dhe video-projektorë duke iu dhënë mundësi studentëve për të punuar në mënyrë individuale dhe në grup duke bërë të mundur që numri i konsiderueshëm i posteve të punës në ambjentet e bibliotekave, dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, të mundësojë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Aktualisht biblioteka digjitale "U Library" shërbim ky

	i ofruar nga MAS ofron një numër të madh burimesh elektronike mbi 170.000 libra mbi 70 milionë artikuj akademik. Gjithashtu biblioteka J-Store siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj akademik, libra dhe burime parësorë në 75 disiplina. <i>GVJ rekomandon nga sa më lartë rritjen e aksesueshmërisë me më shumë vende me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur nga fakti se programi i studimit MD ka natyrën dhe dinamikën e cila dikton nevojën e vazhdueshme për përditësim me literaturë të viteve të fundit, në një pjesë të mirë të programeve të lëndëve gjithashtu rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit. Nevojë kjo e cila nxit frekuentim e bibliotekës elektronike më shumë. Por sidomos edhe nga kjo disponueshmëri e madhe e bibliotekave online që UNIKO ofron.</i> <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.5 Biblioteka Vizita në Institucion
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se Biblioteka e Fakultetit operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve në orarin e vënë në dispozicion. Orari i shërbimit të bibliotekave, i shpallur gjatë ditëve të javës është: 8:00- 16:00. Për një kapacitet përdoruesish prej: 80 vende studimi. Me një hapësirë studimi prej 163 m² si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve prej 8 vendesh. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse.




shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programit Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program, por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës bazë, të detyrueshme më dinamike e të viteve të fundit në shumë programe të lëndëve në programin e studimit MD.</i> <i>Gjithashtu lipset rritje e aksesueshmërisë me më shumë vende me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur jo vetëm nga fakti se në programin e studimit MD, në një pjesë të të programeve të lëndëve rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit për shkak edhe të natyrës së këtij programi studimi, nevojë kjo e cila nxit frekuentimin e bibliotekës elektronike më shumë. Por sidomos edhe nga kjo disponueshmëri e madhe e bibliotekave online që UNIKO ofron për studentët dhe stafin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se sekretaria e UNIKO_së është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve të programin Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi që përdoret mbi bazën e marrveshjes që UNIKO ka bërë me RASH, është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre. Sistemi mundëson efikasitet në administrimin e bazës së të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje e informacionit në kohë reale nga ana e studentit, shërbime më të mira sekretarie që lehtëson proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.6 Marrëveshje me RASH për sistemin elektronik Pitagora Vizita në Institucion
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik i angazhuar në programin Master Profesional në Marketingu Digjital, menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Ndërsa, Drejtoria e Financës posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat. <u>Referenca:</u> RVB



	<i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma apo sistemi PITAGORA mundëson efikasitet në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie që lehtësojnë proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, paraqitjen në rrjet të grafikut të provimeve, të rezultateve, krediteve, kurrikulës dhe programet lëndore. Rregullorja e këtij programi përcakton funksionet e sistemit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personave të përfshirë. Ndërsa hyrja në sistem mundësohet edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 4.13 Manuali për përdorimin e sistemit elektronik Pitagora Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se, platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e UNIKO-s, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion ky sistem elektronik konsiderohet si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët. UNIKO gjithashtu publikon informacione në faqen e vet zyrtare, www.unikorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht. Programi i Transparencës, i instaluar në këtë faqe, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë, etj. GVJ konstatoi gjithashtu se plani strategjik i zhvillimit të IAL_së parashikon që sistemi interaktiv i komunikimit të integrojë mësimin elektronik dhe të nxëniet nëpërmjet TIK-ut në funksion të përmirësimit të aftësive pedagogjike të stafit akademik dhe cilësisë së mësimdhënies. <u>Referenca:</u> RVB

	<i>Shtojca 1.3 Plani strategjik I zhvillimit UNIKO 2022-2027</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të IAL_së garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <u>Referenca:</u> RVB <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të IAL_së publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu në rrjetet sociale çdo fakultet dhe departament pasqyron informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Vizita në Institucion</i> https://unkorce.edu.al/			
Konkluzione	GVJ shprehhet se standardi përmbushet plotësisht, UNIKO përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë Universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të IAL_së. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, UNIKO publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ duke u bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton se Departamenti i Marketing Turizmit funksionon në përbërje të njësisë kryesore (Fakultetit të Ekonomisë), dhe padyshim është pjesë e njësisë së vetme shpenzuese të UNIKO, pa pasuar buxhet të individualizuar në kuptimin e njësisë shpenzuese. Buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UNIKO. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu hartimi i buxhetit të UNIKO-s fillon nga njësia bazë, pra që nga departamenti, duke marrë parasysh nevojat e secilit prej tyre duke, u varur edhe nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo department. Ndërsa plani i financimit miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027</i> <i>Shtojca 4.10 Kosto për student</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se hartimi i planit të financimit të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Marketingu Digjital, bazohet në strukturën buxhetore që përdoret për hartimin e buxhetin e shtetit, sipas zërave kryesorë buxhetorë: Shpenzime nga grandit buxhetor, si dhe Shpenzimet nga të ardhurat e veta. Në vijim plani i financimit të DMT detajohet në mënyrë më analitike me gjithë elementët e shpenzimeve që parashikon për mbulimin e shpenzimeve operative, burimeve njerëzore, investimet për logjistikën dhe pajisjet. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	IAL ja auditohet në mënyrë periodike nga dy hallka kryesore. Auditimi i brendshëm financiar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit. Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si edhe nga auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi	Bazuar në informacionin e DVV në fund të çdo viti UNIKO, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve.

realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<u>Referenca:</u> RVB Shtojca 4.11 Fondet dhe të ardhurat e UNIKO Vizita në Institucion			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UNIKO është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UNIKO janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Në rastet kur ka kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese të UNIKO, në rastet kur nevojitet financim shtesë, apo përmirësim i situatës financiare, ri-planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve (apo në regjistrin e prokurimeve) për nevoja të ndryshimeve eventuale të financimit të programeve të studimeve, duke garantuar mbarëvajtje të veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor apo të programeve të studimit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se UNIKO harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raportet përcillen deri në njësinë bazë. UNIKO si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UNIKO-s, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UNIKO-s dhe FE specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027 Shtojca 1.34 Rregullore FE Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Vizita në Institucion https://unkorce.edu.al/
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UNIKO-s, GVJ konkludon se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantojnë nga ky institucion. Barazi kjo si në lidhje me regjistrimin ashtu edhe përgjatë studimeve, në lidhje me procesin e mësimdhënies, vlerësimit dhe me shërbimet mbështetëse që ofrohen në përputhje me statutin e UNIKO.

	<u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Shtojca 1.34 Rregullore FE Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që UNIKO harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Konstatohet se në programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Marketingu Digjital, pranohen studentë duke u bazuar në udhëzimet dhe kuotat e paracaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe MAS, për vitin akademik përkatës. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të lartë Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 1.34 Rregullore FE Shtojca 1.46 Rregullore DMT Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 15 dt. 20/05/2020; Udhëzim Nr. 17 dt. 30/07/2019; Udhëzim Nr. 10 dt. 15/05/2019; Vizita në Institucion
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit. Studentët mund të marrin informacion të plotë si nëmomentin qëkërkojnë të regjistrohen ashtu edhe gjatë vitit. <u>Referenca:</u>

	<i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>udherefyresi2022.pdf(unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyresi2022.pdf
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO përveç komunikimit elektronik, për informimin e publikut shërbejnë dhe takimet me të diplomuarit e ciklit të parë bachelor, si dhe aktivitetet që organizohen nga Fakulteti apo edhe Departamenti i MT. Universiteti menaxhon edhe forma informimi më të gjerë si Guida e Universitetit, broshura promocionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimi, si dhe lajmërimi në media. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO-s në rrjete sociale (FB dhe Instagram), mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 12 dt. 30/06/2023</i> https://unkorce.edu.al/ https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyresi2022.pdf
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se UNIKO ka hartuar kuotat e pranimi për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Master Profesional në Marketingu Digjital nuk përjashton mundësinë e integritetit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Ky program studimi, parashikon kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marginalizuara. Gjithashtu IAL_ja, këta studentë, i përjashtohen nga pagesat e tarifave të shkollimit bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, dhe stafi akademik tregon ndjeshmëri dhe përkushtim për përfshirjen e tyre të plotë në procesin mësimor.




	<u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 12 dt. 30/06/2023 Vizita në Institucion
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullator të UNIKO-s parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetrorë, si edhe nga çdo shtetas i huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Shtojca 1.34 Rregullore FE Vizita në Institucion
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UNIKO duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar sikurse është konsideruar gjithashtu edhe ky program studimi. Gjithashtu studentët mund të përfitojnë bursa studimi nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe shpërblime të veçanta. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.25 VKM Nr. 903, dt 21.12.2016 me ndryshime Vizita në Institucion
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të UNIKO parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet Master Profesional në MD, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. IAL ja ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UNIKO, vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit Ekonomisë dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por UNIKO aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit apo sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.34 Rregullore FE <u>udherefyresi2022.pdf (unkorce.edu.al)</u> <u>https://unkorce.edu.al/</u> Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit Vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	GVJ bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, konstatoi se UNIKO përmes sekretarive të programeve të ciklit të dytë dhe bazuar në rregullore të FE informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për

mëparshme ose studimeve të pjesshme.	njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit, sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.34 Rregullore FE Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al) Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve që ditën e parë që rregjistrohen, por edhe gjatë vitit. Studentët mund të marrin informacion të hollësishëm edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit, sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.34 Rregullore FE Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët e programit të studimit Master Profesional në Marketingu Digjital ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Përgjegjësi i Departamentit përgatit dhe miraton listën përfundimtare të temave të diplomës sipas fushave të studimit dhe i vendos në dispozicion të studentëve në muajin dhjetor. Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Diplomimi bëhet me realizimin e një teme diplome ku studentët në bashkëpunim me udhëheqësin e kanë përgatitur

	atë. Referuar rregullores së njësisë bazë, në dhjetor, departamenti përcakton fushat e studimit, listën e temave të diplomës si dhe pedagogun udhëheqës. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës dhe peshën që zë kjo kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Shtojca 2.13 Fushat e studimit dhe temat e diplomës</i> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomës</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <u><i>udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al)</i></u> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të UNIKO-s, GVJ konstatoi se Departamenti i Marketing Turizmi, në koordinim me strukturat e FE dhe UNIKO, përfshirë edhe QKA, organizon takime informuese duke synuar dhënien e informacioneve të nevojshme në lidhje me elementët e përmbajtjes së programeve të studimit dhe nevojat e tyre të të nxëniet. UNIKO organizimi gjithashtu fushata promovuese me studentë të viteve të fundit bachelor, harton broshurave informative dhe prezantime gjatë vizitave në të përbëjnë një pjesë të veprimtarive të realizuara. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ e gjykon këtë kriter të përmbushur plotësisht, duke konstatuar se UNIKO vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi</i>

	<i>procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ duke u bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konkludon se studentët e programit të studimit Master Profesional në Marketingu Digjital, informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritet dhe faqja zyrtare web e UNIKO për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore FE Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit https://unkorce.edu.al/archive/programet_studimet/FE/index.php Vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve	GVJ duke u bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, konstatoi se IAL-ja publikon në faqen e vet zyrtare,




informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	www.unkorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht me informacion. Gjithashtu, programi i transparencës, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë akademike, administrative dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë. GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në UNIKO në kuadër të orientimit, ku më i rëndësishmit janë Ditët e Promocionit, ku ofrohet informacion mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si edhe aspekte të tjera të rëndësishme në lidhje me programin Master Profesional në Marketingu Digjital. Gjithashtu GVJ konstatoi se programet e lëndëve gjenden në formë elektronike dhe hard copy në dokumentacionin e Departamentit si dhe publikohen në faqen online të sistemit në profilin e pedagogut që i zhvillon ato lëndë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <u>UNIKO - PROGRAMET E STUDIMIT (unkorce.edu.al)</u> <u>Fakulteti i Ekonomisë - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</u> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO ka lidhur 46 marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Stafi akademik i FE dhe DMT, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës, në mënyrë sistematike, angazhohet në përpjekje konkrete që kanë të bëjnë me orientimin e studentëve në tregun e punës, në eksplorimin e mundësive dhe alternativave për administrimin e karrierës së tyre. DMT realizon studim tregut të punës i cili ka siguruar një rrjet komunikimi institucional, që përfshin institucionet arsimore në rajon, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, njësitë administrative, bizneset private. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.29 Studime tregu</i> <u>Mundësi Punësimi - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</u> <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se sekretaritetë mësimore si dhe pedagogët e Departamentit të Marketing Turizmit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik. Gjithashtu Sektori i Studimeve menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO në rrjete sociale (FE dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime etj. <u>Referenca:</u> RVB udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se UNIKO dhe FE kanë ngritur një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Sektori i Studimeve menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu ky informacion shpërndahet në rrjete sociale (FE dhe Instagram) shpallet në stenda dhe monitorë të dukshme në fakultet. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Vizita në Institucion

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në UNIKO studentët e programit të studimit Master Profesional në MD, informohen nga pedagogët përkatës, sekretarët dhe faqja zyrtare web e UNIKO si edhe Sektori i Studimeve për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</i> <i>FE ka dhe rrit numrin e marrëveshjeve, duke ua vënë në dispozicion studentëve me qëllim orientimin e tyre drejt tregut të punës, gjithashtu kujdeset për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO nëpërmjet Sektorit të Studimeve dhe TIK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e platformës “PITAGORA” së sistemit dixhital të të dhënave të universitetit, si një mënyrë efikase dhe praktike komunikimi. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	Gjatë vizitës në USH, GVJ konstatoi se në UNIKO krahas sektorit të Studimeve dhe TIK i cili menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve. Duke menaxhuar mbledhur, përpunuar, transmetuar dhe shfrytëzuar të dhënat që

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu edhe Sekretaria Mësimore mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore për regjistrimet e studentëve sipas programeve, përfshi numrin e studentëve të regjistruar, numrin e të diplomuarve, numrin e studentëve që ndërpresin studimet.

Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Për 3 vitet e fundit akademike në këtë program studimi rezultojnë të jenë të regjistruar si vijon.

Viti akademik	Të regjistruar	Të transferuar
2022-2023	15	
2023-2024	10	1
2024-2025	15	
Totali	40	1

Ndërsa për periudhën 2022-2024 rezultojnë të jenë diplomuar në këtë program studimi 22 studentë.

Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen personale dhe të ecurisë akademike të një studenti të programit të studimit Master Profesional në Marketingu Digjital, MP_MD dhe konstatoi plotësinë e tij.

Referenca:

Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK

Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT

Vizita në Institucion

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

GVJ duke e bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UNIKO_s dhe Fakultetit të Ekonomisë. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve. Ai menaxhon mbledhjen, përpunimin, transmetimin dhe shfrytëzimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Ai koordinon mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e

	tyre në bashkëpunim me sektorët e administratës në Rektorat. Sektori përpunon statistikat e të dhënave të ndryshme nga viti në vit dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në universitet. Informacioni përcillet edhe në bazën e të dhënave të sistemeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve. Studentëve u jepet mundësia të regjistrohen (krijojnë llogari me user name dhe password unik) në sistemin Pitagora. Në këtë sistem, ka të dhëna për studentët në nivel individual dhe hidhen të dhënat nga pedagogët në lidhje me vlerësimin e studentëve (gjatë vitit dhe në provime) <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO kontrollon në mënyre periodike në nivel fakulteti dhe universiteti të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse. Sektori i kurrikulës vlerësimi institucional dhe Alumni, është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Në Manualin e Cilësisë të UNIKO përshkruhet e tërë veprimtaria e tij dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete, sekretaritet mësimor dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe	GVJ duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB por edhe dokumentacionit në DVV, njësia bazë DMT, në mënyrë periodike, harton dhe analizon raporte analitike mbi ecurinë e

cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	veprimtarisë akademike e mësimore, ku ndër të tjera, evidentohen edhe aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë, në hyrje dhe dalje të studentëve, dhe në lidhje me sfidat dhe mundësitë e punësimit të tyre. Njësia bazë mbështetet në këtë informacion për të realizuar analizat periodike. <u>Referenca:</u> Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT Shtojca 2.5 Të dhëna nga sektori i studimeve dhe sektori TIK Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UNIKO mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UNIKO_s mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ duke u bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatoi se UNIKO në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundur ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UNIKO, dhe në Bordin e Administrimit. Këshillat studentore në UNIKO kanë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe

	ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstatoi se jo vetëm në statutin e UNIKO por edhe në rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese</i> <i>Shtojca 1.17 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi se aktualisht UNIKO përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor dhe stafin akademik. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.1 Modeli dhe raporti i pyetësorit studentor</i> <i>Shtojca 1.5 Rregullore DKVI</i> <i>Shtojca 2.16 Model pyetësori fundkursi</i> <i>Shtojca 2.17 Relacion i pedagogut</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UNIKO, GVJ konstatoi se në çdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët

kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. Gjithashtu të ankohen apo të ndjekin ankesat e tyre në lidhje me vlerësimin. Keto procedura janë një praktikë e rregulluar dhe konsoliduar në këtë institucion. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 4.12 Regjistri i pedagogut</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UNIKO mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UNIKO mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. DMT në bashkëpunim me Zyra e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstatoi se UNIKO është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), duke mundur, në këtë mënyrë përdor sistemin "Pitagora" si një sistem dixhital në shërbim të studentëve. UNIKO nëpërmjet kësaj platforme mundëson komunikimin e stafit akademik dhe studentëve duke përfshirë komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. Por një tjetër rrugë komunikimi kanë qënë edhe rrjetet sociale të internetit, të gjitha këto forma kanë mundur informimin në kohë reale të të gjithë palëve të interesit mbi aktivitetin e UNIKO. Gjithashtu edhe sekretaritet apo zyrat administrative të institucionit janë në dispozicion të



	studentëve në cdo rast. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se në UNIKO dhe FE është ngritur një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor. I gjithë informacioni i detajuar në lidhje me programet e studimit të ofruara, stafin akademik, kurrikulën, rezultatet e të nxënit, kurset dhe rezultatet e provimeve, paraqitet në llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora. Sektori i Studimeve dhe TIK si edhe Sekretariteti garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecures së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.31 Modulet orientuese për studentët Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione	DVV, GVJ konstaton se NJSBC e UNIKO vazhdimisht përdorin mjete për të vlerësuar përparimin e studentëve. UNIKO gjithashtu nëpërmjet Qendrës së Karrierës, ka krijuar profilin e një ure lidhëse mes tregut dhe UNIKO duke synuar përditësimin e vazhdueshëm të njoftimeve për vende të reja pune. Qendra gjithashtu njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Zyra e punës. Sa i takon orientimit në praktika profesionale dhe tregut të punës. UNIKO ka ndihmuar në drejtim të marrveshjeve që ka me 46 Institucione dhe Organizata bashkëpunuese. <u>Referenca:</u> RVB

të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional & Alumni dhe Qendra e Karrierës organizojnë trajnime dhe aktivitete të ndryshme me studentët, ku diskutohet dhe orientohen studentët, mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve dhe përpilimin e dosjes personale, prezantimin gjatë intervistave të punës. Gjithashtu studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO në rrjete sociale (FB dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime.			
	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Sekretaritetë Mësimore dhe e Karrierës dhe ALUMNI të UNIKO janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga. Qendra Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në UNIKO, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UNIKO, GVJ konstatoi se UNIKO i ka strukturat dhe procedurat të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Këto struktura janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO Vizita në Institucion
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët, konstatoi se UNIKO monitoron në vazhdimësi proceset, veprimtaritë, burimet njerëzore dhe kontekstin në të cilin realizohet misioni i tij si një qendër arsimore dhe kërkimore. Treguesit kryesorë të performancës maten, përmes hartimit të raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të vazhdueshëm të dokumentacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të rolit të stafit dhe studentëve në sigurimin e cilësisë, përmes anketave dhe pyetësorëve, përcaktimit të rekomandimeve për përmirësim dhe ndjekjes në vijimësi të masave të ndërmarra. Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm i cili zhvillohet nga NjSBC në bashkëpunim me këshillin studentor. Performanca e stafit akademik vlerësohet në kuadër të arritjeve në fushën e akademike dhe kërkimore të gjithsecilit nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli, si dhe gjatë analizave vjetore të departamentit sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë. <u>Referenca:</u> Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE

	<i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.1 Modeli dhe raporti i pyetësorit studentor <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente; synimi është nxitja e diskutimit në lidhje me nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies apo infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <u>Referenca:</u> Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues së NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve në dekanat dhe departament, ka si qëllim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Nga UNIKO stafi akademik mbështetet të kryejë studime brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet vitit sabbatik, si dhe nxitet të marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta diskutimesh dhe në trajnime, që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve ndërkombëtare ku universiteti është pjesë. UNIKO promovon stafin akademik nëpërmjet organizimit të veprimtarive që prezantojnë për një publik më të gjerë kontributin akademik dhe

	shoqëror të kërkimit shkencor të stafit të tij. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al) Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretariteti Mësimor dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit të UNIKO janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në UNIKO, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion konstatoi se, në planin strategjik 2022-2027 të UNIKO, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë. Në FE siguri i brendshëm i cilësisë realizohet sipas rregullave të përcaktuara të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FE "Vlerësimi i cilësisë "ku specifikohen procedurat dhe strukturat për vlerësimin e cilësisë. Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA) është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve

	kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.1 Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë të FE Shtojca 1.3 Planin strategjik i zhvillimit UNIKO 2022-2027 Vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se UNIKO ka krijuar strukturat e brendshme, proceset dhe udhëzimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ka në përbërje një njësi të posaçme që merret me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe me bashkërendimin e procedurave që synojnë përmirësim të vazhdueshëm. Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e planeve për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës në fakultete, dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit, për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të lartë Shtojca 1.33 Kurrikula e Programit të Studimit Shtojca Kodi i Cilësisë Vizita në Institucion

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UNIKO realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. UNIKO i është nënshtruar (dy herë) Akreditimit Institucional, ndërsa vetëvlerësimi i programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në Marketingu Digjital, po kryhet në kuadër të procesit të akreditimit për herë të parë, i cili do të pasohet nga ky vlerësimi i jashtëm, që po realizohet nga ASCAL. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.24 Manuali për vlerësimin e performacës së stafit akademik</i> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i> https://unkorce.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UNIKO dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e treguesve të performancës, (pjesë e raporteve vjetore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore), diskutohen në fund të çdo viti, në takimet e organizuara me anëtarët e stafit akademik të departamentit, me fokus promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, shkencore dhe Financiare e FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>



Konkluzione	GVJ konstatoi se në UNIKO procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Instrumentat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecures të realizuara në nivel Departamenti, Marketing Turizmi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe RVB se FE, bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore duke angazhuar komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregulloreve përkatëse. UNIKO përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.24 Manuali për vlerësimin e performacës së stafit akademik</i> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi nga RVB si edhe dokumentat e DVV se raportet e analizës vjetore të mësimit dhe punës kërkimore shkencore që kryhet në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe IAL-je. Të cilat përfshijnë performancën e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj, qoftë atë mësimor apo kërkimor si dhe formimin profesional të studentëve. Këto raporte përmbledhin evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Komisioni i sigurimit të cilësisë, programeve të studimit e kërkimit shkencor - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>Relacioni permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf (unkorce.edu.al)</i> <i>https://unkorce.edu.al/</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se UNIKO vlerësimi i treguesve të performancës, të realizimit apo mbarëvajtjes së programeve të studimit, bazohet në metodologji e cila synon matjen/vlerësimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë, lidhur me programet e studimit që ofron njësia bazë mbi procesin mësimor, performancën e stafit akademik, studentët, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë mbështetëse etj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bazohet në të dhënat që përftohen nëpërmjet anketimit të studentëve. Gjithashtu, janë aplikuar edhe orë të hapura leksionesh nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), me qëllim ofrimin e përvojës së tyre në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies nga ana e lektorëve të rinj. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i>

106

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, shkencore dhe Financiare e FE</i> <i>Shtojca 6.6 Platforma Clean Score</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>https://unkorce.edu.al/</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ duke u bazuar në informacionin e DVV dhe RVB, konstatoi se programet e studimit në UNIKO i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet instrumentave të tërthorta të NJBSC-së, organeve vendimmarrëse, stafit akademik dhe studentëve. Këto instrumenta rezultojnë të jenë kompleks: Sjellja dhe veprimtaria e stafit akademik matet edhe me të dhëna e pyetësorëve të studentëve, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në FE, për të vlerësuar programet e studimit. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit Master Profesional në Marketingu Digjital. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>Relacioni permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf (unkorce.edu.al)</i> <i>https://unkorce.edu.al/</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UNIKO së fundmi ka pasuruar kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ duke u bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UNIKO, konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Cilësisë specifikohen funksionet e të gjitha strukturave që nga Senati Akademik dhe deri tek pedagogët. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 6.1 NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Statuti i UNIKO thekson organizimin strukturor të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet rrjetit të cilësisë apo DKVIA e ngritur në nivel IAL-je si dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSB) në çdo njësi kryesore të UNIKO. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 6.1 NJSBC</i>

	<i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ vlerëson se UNIKO garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vlerëson se UNIKO nëpërmjet DKVIA, në bashkëpunim me njësitë bazë si edhe SKVIA garanton procesin e sigurimit të cilësisë është gjithëpërfshirës, transparent, i diskutuar me stafet dhe i bazuar në formate e procedura të miratuara dhe të bëra publike. Pranë FE është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi. Kjo njësi funksionon në respektim të plotë të integritetit të aktorëve. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UNIKO angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe institucioneve të jashtme që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ky bashkëpunim konsiston në ndihmë të procesit të realizimit të praktikave mësimore-profesionale, FE ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me operatorë të sektorit privat si dhe me institucione të ndryshme rajonale, duke u përpjekur t'i përfshijë ata, në diskutime dhe shkëmbim opinionesh, me synim përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programeve të studimit.

	<u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT Vizita në Institucion			
Konkluzione	Kkuadri rregullator i UNIKO përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si, leksione të hapura me biznese private por edhe personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UNIKO realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ duke u bazuar në informacionin e dhënë në RVB, DVV dhe takimeve në institucion, konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti dhe përfshijnë një sërë dokumantash që janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme. Faqja web është e pasuruar me informacione, por <i>gjithsesi GVJ rekomandon që informacioni të jetë edhe në gjuhën angleze, si një mënyrë shumë e mirë për të rritur numrin e studentëve hyrës në këtë institucion.</i>
	<u>Referenca:</u> RVB

	<i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare web të UNIKO dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Gjithashtu rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, diskutohen në takimet e organizuara në nivel departamenti, në të cilën merren masat për përmirësimin e dobësive. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi se FE, në bashkëpunim me departamentet (përfshi edhe DMT), në fillim të çdo viti akademik miraton një plan veprimi aktiviteteve, të cilat kanë të adresuara dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga proceset e vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit në vitin paraardhës, me qëllim përmirësimin e ecures së programeve të studimit për vitin e ri akademik. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UNIKO realizohen periodikisht analiza gjithashtu si edhe në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. Raportet e veprimtarisë së DMT

vijim të cilësisë së programit të studimit.	përmbajnë jo vetëm analizën e ecurisë dhe arritjet por gjithashtu japin dhe rekomandimet përkatëse për përmirësime të nevojshme. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 2.5 Tëdhëna nga sektori I studimeve dhe sektorit TIK https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se takimet e organizuara në nivel të Njesisë Kryesore (FE) dhe të Njesisë Bazë (DMT) ofrojnë informacione të nevojshme tek stafi akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore, në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme të cilësisë së personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës . <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion			
Konkluzione	UNIKO publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketingu Digjital”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit mbështetet në një kurrikul që plotëson nevojat e tregut të punës lokal dhe më gjerë si dhe në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik rajonal në drejtimin e marketingu digjital;
2. UNIKO dhe DMT kanë nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi përmes të cilave mundësohet organizimi i aktivitete të ndryshme në lidhje me shkëmbimin e eksperiencave midis tregut të punës dhe akademisë, përshtatjen e programit me nevojat e tregut, dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit;
3. Institucioni organizon konferenca studentore që të angazhohen dhe inkurajohen studentët për të shprehur identetë e tyre inovative dhe për ti afuar ata drejt kërkimit shkencor;
4. Përfshirja e studentëve në mobilitetet ndërkombëtare është positive;
5. Programi i studimit është organizuar në mënyrë të strukturuar mirë, me një kurrikul të pasur, duke harmonizuar përfshirjen e lëndëve bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore të fushës së marketingut dhe të teknologjisë së informacionit;
6. Stafi është i angazhuar në projekte lokale dhe ndërkombëtare duke zhvilluar kështu mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional në funksion të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulës;
7. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese;
8. Stafi akademik përgjegjës për këtë program studimi është shumë i përkushtuar, me cilësi shumë të mira në mësimdhënie dhe kualifikimin e tyre, të gjithë me grada shkencore dhe tituj akademik;


b. Pika të dobta:

1. Evidentohet një shpërndarje jo e qartë e orëve të praktikës në lëndët e këtij programi studimi si dhe sasi e vogël e orëve të praktikës profesionale që ndjekin studentët në terren. (*Standarti II.4, kriteri 3*)
2. Stafi akademik PAE dhe PAK në Departamentin e Marketing Turizmit rezulton me një sasi lëndësh të realizuara shumë të lartë, deri në 8 lëndë në vit ose sasi orësh përtej normës së lejuar, duke rënë ndesh me kornizën ligjore në fuqi, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268. (*Standarti IV.1, kriteri 2*)
3. Programet Lëndore të lëndëve të Programit Master Profesional në “Marketingu Digjital”, kanë në një pjesë të lëndëve që vijojnë të përdorin një literaturë të pa përditësuar me botime të pesë viteve të fundit. (*Standarti II.4, kriteri 5; Standarti IV.3, kriteri 1*)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon një përcaktim më të qartë të ndarjes së orëve të seminareve në lidhje me orët e praktikës, orë laboratorit apo ushtrime, sipas specifikave të lëndëve në mënyrë që të jenë më të orjentuara drejt kompetencave profesionale. GVJ rekomandon që të rritet sasia e orëve të praktikës dhe si rrjedhim edhe pesha e saj në formimin e studentëve;
2. GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve të informatikës për t’ju mundësuar studentëve të këtij programi, por jo vetëm, që të aplikojnë njohuritë teorike të marra në leksione në baza praktike, për të qenë më të përgatitur për tregun e punës;
3. Departamenti i Marketing Turizmit përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Marketingu Digjital” të reduktojë sasinë e lëndëve dhe të orëve të mësimi që mbulon stafi akademik, si ai efektiv edhe ai me kontratë, për të qenë në përputhje me kudrin ligjor, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268. GVJ rekomandon shtimin e stafit akademik, për të pasur një shpërndarje më të ekuilibruar të orëve të mësimi;
4. Literatura bazë e detyrueshme në programin mësimor duhet përditësuar mbi bazën e botimeve të 5 viteve të fundit;
5. Rekomandojmë rritjen e kapaciteteve dhe mjeteve kompjuterike nëpërmjet desktop_ëve, pc, etj. në dispozicion të përdoruesve të bibliotekës e-book në mjedisin e bibliotekës. Në mënyrë që biblioteka online të mund të aksesohet nga sa më shumë studentë njëkohësisht në funksion të përgatitjes së tyre për detyrimet e lëndëve por edhe për punët kërkimore;



114 

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in "Digital Marketing"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is based on a curriculum that meets the needs of the local and broader labor market, as well as aligns with the strategic objectives of regional economic development in the field of digital marketing;
2. UNIKO and DMT have signed several cooperation agreements through which various activities are organized, enabling the exchange of experiences between the labor market and academia, adapting the program to market needs, and developing students' professional internships in line with the requirements of the study program;
3. The institution organizes student conferences to engage and encourage students to express their innovative ideas and bring them closer to scientific research;
4. The inclusion of students in international mobility programs is positive;
5. The study program is well-structured, with a rich curriculum that harmonizes the inclusion of core, characteristic, and interdisciplinary courses in the fields of marketing and information technology;
6. The staff are engaged in local and international projects, thereby developing specific mechanisms to support and enhance professional qualifications in line with contemporary teaching methods and curriculum improvement;
7. The study program enjoys strong support from the management structures;
8. The academic staff responsible for this study program is highly dedicated, with excellent teaching quality and professional qualifications, all holding scientific degrees and academic titles;

b. Weaknesses:

1. There is an unclear distribution of practice hours across the courses in this study program, as well as a small number of professional practice hours that students complete in the field. *(Standard II.4, criterion 3)*
2. The academic staff (full-time and part-time) in the Department of Tourism Marketing has a very high teaching workload, covering up to 8 courses per year or many teaching hours beyond the allowed norm, which is inconsistent with the current legal framework, as per Instruction No. 29, dated 10.09.2018, No. 9268. *(Standard IV.1, criterion 2)*
3. The course syllabi of the Professional Master's Program in "Digital Marketing" still include, in part, outdated literature that does not reflect publications from the last five years. *(Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1)*

Recommendation

1. The External Evaluation Group recommends a clearer definition of the distribution of seminar hours in relation to practice, laboratory, or exercise hours, according to the specifics of each course, so that they are more oriented toward professional competencies. GVJ also recommends increasing the number of practice hours and, consequently, their weight in student internships;
2. The External Evaluation Group recommends adding more computer laboratories to enable students of this program, and others, to apply the theoretical knowledge gained in lectures to practical settings, to be better prepared for the labor market;
3. The Department of Marketing Tourism, responsible for the Professional Master's Program in "Digital Marketing," should reduce the number of courses and teaching hours covered by both full-time and contracted academic staff, to comply with the legal framework, as per Instruction No. 29, dated 10.09.2018, No. 9268. Also, we recommend recruiting more academic staff to ensure a more balanced distribution of teaching hours;
4. The core mandatory literature in the curriculum must be updated based on publications from the last five years;
5. We recommend increasing the capacities and computer resources, such as desktops, PCs, etc., available to users of the e-book library in the library environment. This would allow more students to access the online library simultaneously, supporting their preparation for course requirements as well as research work;

A handwritten signature in blue ink is written over a blue circular stamp. The stamp contains the number 146.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X